



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.75/2016

Prishtinë, më 25.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, z.v. kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha, Enver Hoti, dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Sasha Milosavljeviq, zv.kryetar.

E ftuar: Hykmete Bajrami, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Krasniqi, Agron Maxhuni, Rexhep Bllaca – MTI; Vitomir Fister – FMG-MTI, Blerta Bejtullahu – UESN/EU Office, Etleva Malushaj – LVV, Granit Brajshori – GIZ, Fjolla Uka – KDI, Amir Kozmaqi – INDP, Shefki Kastrati – NDI, Arlinda Bajrami – Instituti GAP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Shkëlzen Behrami praktikant i komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.10.2016;
3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioritetëve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditim;
5. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.10.2016

Procesverbali nga mbledhja e datës 18.10.2016, u miratua pa vërejtje.

3.Raportim i znj.Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm

Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, paraqiti para deputetëve objektivat e ministrisë, realizimin e projekteve për nëntë muajt e këtij viti si dhe prioritetet për vitin e ardhshëm. Ministria paraprakisht e ka ofruar më shkrim raportin.

Me këtë rast për ministren u shtruan pyetje dhe u ngritën disa çështje nga anëtarët e Komisionit, si **Raif Qela, Blerim Grainca, Glauk Konjufca, Rrustem Berisha, Fatmir Rexhepi, Besim Beqaj, Enver Hoti dhe Sala Berisha – Shala**, të dhëna në transkript pjesë e këtij procesverbali.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Komisioni mirëpriti Raportin e ministrës Bajrami dhe pas një serë sugjerimësh e pyetjesh, i rekomandon Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), që në pajtim më ligjin të:

- 1. Të ndërmerren masat e duhura ligjore për të përmirësuar cilësinë e naftës në nivel të standardëve europiane dhe të definohet në mënyrë adekuate roli dhe arsyeshmëria e trupave për vlerësim të konformitetit, dhe definitivisht kjo çështje të zgjidhet pasi po diskutohet një kohë të gjatë;*
- 2. MTI, dhe Qeveria të merr masat e duhura që Agjencia e Statistikave të Kosovës duke filluar nga viti i ardhshëm të siguron publikimin e rregullt të statistikave kombëtare në prodhim industrial dhe punësim;*
- 3. Të bëhen analiza më të gjithanshme për lëvizjen e eksportit dhe investimeve të jashtme dhe të zbatohen masa për rritjen e tyre dhe në raportimet e ardhshme të prezentohen në Komision;*
- 4. Të nxirren në afatet e parapara ligjore aktet nënligjore të Ligjit për investimet strategjike;*
- 5. Të merren masa konkrete për mbështetjen e prodhimit vendor në pajtim me MSA-në;*
- 6. Të analizohen marrëdhëniet tregtare me Serbinë, problemet e eksportit atje dhe në të gjitha rastet e problemet të merren masat përkatëse të reciprocitetit;*

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditim

Kryetari, tha se për këtë Projektligj është dashur të raportojë deputeti Enver Hoti, mirëpo, me leje ai e ka lëshuar mbledhjen dhe nëse ka nevojë për sqarime, atë e zëvendëson deputeti Besim Beqaj, që është anëtar i grupit të punës. Më pas ai i paraqiti amendamentet një nga një për shqyrtim dhe miratim.

Amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.1. fjalia “dhe kërkesa të tjera shtesë,” zëvendësohet me “dhe, aty ku është e aplikueshme, edhe kërkesa të tjera shtesë,”.

Miratohet.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.3. pas titullit të përkufizimit, shtohet teksti “(në tekstin e mëtejme DAK)”.

Miratohet.

Amendamenti 3

Neni 3, nënparagrafi 1.9. fjala “organizmi”, zëvendësohet me “organ”.

Miratohet.

Amendamenti 4

Neni 3, nënparagrafi 1.10. riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 5

Neni 3, pas nënparagrafit 1.20. shtohet një nënparagraf i ri.

Miratohet.

Amendamenti 6

Titulli i nenit 4, ndryshohet.

Miratohet.

Amendamenti 7

Neni 4, paragrafi 4, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 8

Neni 5, paragrafi 2, fshihet.

Miratohet.

Amendamenti 9

Neni 6, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 10

Neni 8, nënparagrafi 1.1 ndahet në dy nënparagrafë dhe riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 11

Neni 8, nënparagrafi 1.2., pas fjalës “ekspertizë” shtohet “ dhe trajnimet”.

Miratohet.

Amendamenti 12

Neni 8, në fillim të nënparagrafit 1.6. vendoset fjalia “përfaqëson dhe”.

Miratohet.

Amendamenti 13

Neni 9, paragrafi 1, fshihet fjalia “aktivitete ose”.

Miratohet.

Amendamenti 14

Neni 11, paragrafi 1, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 15

Neni 12, paragrafët 2 dhe 3, bartën dhe riformulohen në nenin e ri 16.

Miratohet.

Amendamenti 16

Neni 13, ndryshohet.

Miratohet.

Amendamenti 17

Kryetari kërkoi sqarime rreth “Këshillit Profesional në nenin 14”.

Besim Beqaj, dha sqarimet se paragrafi 4, i këtij neni është riformuluar, ku “Drejtori i DAK” do të zgjedhë Komisionin e Apelit nga rekomandimi i Këshillit Profesional”.

Pas debatit, Komisioni e miratoi amendamentin 17, si vijon:

Neni 14, paragrafi 4, riformulohet si vijon:

4. Drejtori i Përgjithshëm i DAK-ut, emëron anëtarët e Komisionit të Apelit, nga lista e rekomanduar e Këshillit Profesional.

Amendamenti 18

Neni 15, paragrafi 1, shkurtesa “DAK” zëvendësohet me “Drejtori i Përgjithshëm i DAK-ut”.

Miratohet.

Amendamenti 19

Pas nenit 15, shtohet një nen i ri.

Miratohet.

Amendamenti 20

Neni 16, fshihet.

Miratohet.

Amendamenti 21

Raif Qela, propozoi një riformulim të ri të amendamentit 21, si dhe paraqiti me shkrim përmirësimet teknike dhe gjuhësore për amendamente.

Pas debatit, Komisioni përkrahu propozimet e deputetit për përmirësimet gjuhësore të amendamenteve si dhe e miratoi propozimin për amendamentin 17, si vijon:

Neni 17, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

6. Nëse gjatë finalizimit të procesit të akreditimit konstatohet se Trupa e Vlerësimit të Konformitetit ka dështuar në plotësimin e disa kërkesave për akreditim, DAK-u nxjerr vendim për refuzim të akreditimit ose për dhënie të akreditimit, duke e zvogëluar fushën e akreditimit.

Amendamenti 22

Neni 17, pjesa e parë e paragrafit 7, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 23

Neni 17, pas paragrafit 7, shtohen dy paragrafë të ri.

Miratohet.

Amendamenti 24

Neni 20, paragrafi 1, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 25

Neni 23, paragrafi 1, riformulohet.

Miratohet.

Amendamenti 26

Neni 26, paragrafit 1, i shtohet teksti ri.

Miratohet.

Amendamenti 27

Neni 27, para fjalës “Ministria” vendoset fjala “Qeveria”.

Miratohet.

Pas debatit Komisioni njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti me amendamente i Projektligji Nr.05/L-117 për Akreditim, dhe procesohet për Komisionet e përhershme sipas procedurës.

**5. Të ndryshme;
Çështjet vijuese.**

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përqatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa

MUHAMET MUSTAFA kryetar i Komisionit, ia dha fjalën ministres për të raportuar para Komisionit.

HYKMETE BAJRAMI, faleminderit kryetar i Komisionit z.Mustafa.

Në fushën e legjislacionit është punuar shumë, sidomos në atë të legjislacionit sekondar i cili në masë të madhe i ka munguar MTI-së. Në përgjithësi janë miratuar 4 ligje, 3 ligje të tjera janë në fazën finale dhe së shpejti do të përcjellen në Qeveri, Ligjin për rezervat shtetërore të naftës është në Qeveri për një kohë të gjatë pasi që ka kosto të madhe financiare, ndërsa Ligji për rregullimin e tregut të naftës është në Kuvend. Gjithsej gjatë këtij viti kemi nxjerrë 15 udhëzime administrativve, 6 rregullore dhe 2 koncept dokumente.

Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik - KKZHE ka mbajtur dy takime gjatë kësaj periudhe raportuese.

KKZHE si platforma më e rëndësishme e dialogut publik-privat ka diskutuar çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, si Marrëveshja për Stabilizim Asociim, Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes, adresimi i shumë kërkesave të ardhura nga komuniteti i biznesit në funksion të mënjanimit të barrierave dhe byrokracisë së panevojshme e çështje të tjera dhe ka marrë një sërë vendimesh me interes për përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

KKZHE i ka të funksionalizuara katër grupe punuese të cilat diskutojnë temat e caktuara dhe i paraqesin rekomandimet KKZHE-së, grupe këto të cilat shumë çështje i kanë adresuar pa pasur nevojte të dërgohën në Këshill. Në javën e dytë të Nëntorit pritet të mbahet mbledhja e radhës e KKZHE-së.

Në Indikatorët e Bankës Botërore për Qeverisjen Rregullatore, Kosova ka shënuar progres nga nota 2.6 në notën 4.6. Arsyet për këtë përmirësim janë të shumta, mirëpo kryesoret janë: përmirësimi i procesit të zhvillimit të politikave të Qeverisë dhe rritja e konsultimit gjatë procesit të zhvillimit të politikave; shndërrimi i Gazetës Zyrtare të Kosovës në një databazë gjithpërfshirëse që përfshin të gjitha nivelet e legjislacionit në Kosovë (ligjet, aktet nënligjore, rregulloret e komunave etj.); përmirësimi i procesit të vlerësimit të ndikimit gjatë hartimit të rregulloreve, duke përfshirë edhe miratimin e Udhëzimit të ri për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor dhe funksionalizimin e këtij procesi.

Janë përgatitur raportet periodike për Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, Planin e Punës (PVPQ), zbatimin e vendimeve si dhe inputi për raportin e vendit 2016; janë hartuar analizat relevante të nivelit të zbatimit.

Në raport me informimin e bizneseve rreth MSA-së, janë mbajtur konferenca me 5 sektorë industrialë me potencial për eksport: përpunimi i drurit, metalit, ushqimit, teknologjisë informative dhe komunikimit, si dhe sektori i tekstilit. Janë përgatitë projekt propozimet për IPA 2016; është përditësuar dokumenti planifikues sektorial 2014-2020 (IPA).

Në kuadër të monitorimit të mbarëvajtjes së Dialogut të Stabilizim Asociimit janë përgatitë dhe mbajtë takimet sektoriale në muajin Mars dhe Prill.

Sa i përket objektivit të koordinimit të donatorëve, në muajin qershor është mbajtur një takim me të gjithë donatorët si dhe takime tjera të rregullta të projekteve.

Në kuadër të pjesëmarrjes aktive në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, përkatësisht implementimit të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020, është përgatitur përfaqësimi i MTI-së, përkatësisht Qeverisë së Kosovës në takimet e mekanizmave të këtij Këshilli.

Në kuadër të objektivit të hartimit të dokumenteve strategjike, është hartuar programi i Agjendës së Reformave Evropiane (ERA).

Është filluar me procesin e rishikimit të PKZMSA-së.

Në raport me zbatimin e PKZMSA-së për periudhën raportuese si udhërrëfyes i procesit të integritetit evropian, më poshtë janë të paraqitura informatat e detajizuara, ku janë të ndara në pjesën e legjislacionit dhe masave të zbatimit.

Rezultatet janë: 11 akte legjislative të përfunduara/miratuara; 13 akte legjislative duke u realizuar; 3 akte legjislative në realizim. Masat e Zbatimit janë: 82 aktivitete janë duke u realizuar sipas planit dhe 30 aktivitete janë duke u realizuar.

MTI ka qenë aktive si a përket politikave tregtare dhe mbrojtjes së prodhimit vendor apo thënë më mirë trajtimit fer të kompanive tona nga ana e partnerëve tanë tregtar. Kemi adresuar të gjitha çështjet/barrierat tregtare me Shipërinë (çështja e barërave farmaceutike, grurit, patatës, rrushit, çokollatës etj) dhe kemi mbikëqyrur tregun në vazhdimësi. Me Serbinë gjithashtu kemi vendosë masa reciproke për njohjen e certifikatave të ADR-së dhe nuk kemi larguar masën derisa janë pranuar edhe dokumentet e transportuesve nga Kosova. Aktualisht, nuk kemi barriera të raportuara. MTI ka qenë shumë aktiv në kuadër të CEFTA-s; jemi në përfundim të negociimit të shërbimeve në kuadër të CEFTA-s dhe kemi bërë përgatitjet dhe planin e veprimit për aplikim në OBT. Për më shumë informata për politikat tregtare, shih Aneksin II, në fund të raportit.

Janë hartuar një numër i dokumenteve për politikat industriale, është finalizuar raporti studimor lidhur me zhvillimin e klastereve/grupimeve në Kosovë. Në këtë drejtim deri tani janë krijuar katër bërthama, si: tour operatorët, kopshtet private të fëmijëve, përpunimi i produkteve ushqimore dhe shtëpitë akomoduese, të cilat janë duke e kaluar fazën 4 mujore të testimit si dhe janë planifikuar që të krijohen edhe dy bërthama të tjera me përpunuesit e mjaltit. Janë hartuar dy studime të profileve të sektorëve industrialë të plastikës dhe gomës, si dhe të industrisë kimike. Është hartuar plani i punës së projektit të IPA-s për promovim të konkurrueshmërisë. Me qëllim të promovimit të legjislacionit të infrastrukturës së cilësisë janë organizuar një sërë aktivitete. MTI-ja ka filluar përgatitjen edhe për aplikim në Organizatën Botërore të Turizmit dhe ka zhvilluar takimet e para edhe pse një gjë e tillë duket te jetë sfiduese për shkak të mungesës së antarësisë së vendit tonë në OKB. MTI ka filluar me përpilimin e një sërë dokumentesh për zhvillimin dhe promovimin e turizmit.

Bazuar në databazën që kemi janë gjithsej 859 pika të karburanteve për shitje me pakicë të dizelit dhe benzinës. Prej tyre: 644 janë në funksion, dhe 215 janë jashtë funksionit. Prej 644 pikave në funksion: 526 kanë licenca të vlefshme, 32 janë në procedurë të licencimit dhe pjesa

tjetër janë pikat që gjenden në komunat Leposaviq, Zvečan, Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore. MTI ka bërë një plan të licensimit të pikave të karburantit edhe për atë pjesë; janë 25 zyrtarë të strukturave të veriut që i janë bashkuar MTI-së të cilët janë trajnuar për realizimin e detyrave të punës.

Gjatë këtij viti ka filluar procedura e aplikimit për leje dhe licenca për bizneset që merren me këtë veprimtari. Në mars është miratuar në Qeveri lista e mallrave ushtarake, e harmonizuar dhe përshtatur me Listat e BE-së. Gjithashtu është miratuar në Qeveri lista e mallrave me përdorim të dyfishtë, e harmonizuar me listat e BE-së.

Janë identifikuar afër 90 biznese që konsiderohet që zhvillojnë aktivitete/veprimtari me mallra strategjike. Janë informuar me procedurat e regjistrimit në regjistra dhe të licencimit, shumica nga to janë pajisur me materiale të nevojshme.

Janë certifikuar me regjistër 32 kompani të cilat priten të licencohen bazuar në legjislacionin për mallra strategjike;

Është nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MTI-së dhe Doganës së Kosovës për kontrollin e eksportit dhe shkëmbimin e informacioneve

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MTI-se dhe MB/Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksportit, Republika e Shqipërisë për fushën e bashkëpunimit të kontrollit të eksporteve dhe shkëmbimit të informatave dhe përvojave në këtë sferë.

Është themeluar grupi punues ndërministror për hartimin e strategjisë kombëtare kundër armëve të shkatërrimit në masë; aktualisht është duke u punuar në këtë strategji dhe është finalizuar drafti i parë.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar 166 ankesa të konsumatorëve; 77 % e këtyre kërkesave janë adresuar, të tjerat janë në proces. Këto ankesa iu adresohen institucioneve të ndryshme.

Janë mbajtur dy takime të Këshillit qeveritar për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Qeverinë Hungareze me qëllim të bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe fushën e Inspektimit.

Është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit me organizatën jo-qeveritare “Konsumatori”.

Janë organizuar shumë aktivitete për promovim të të drejtave të konsumatorëve dhe ngritje të vetëdijes së konsumatorëve.

Në fushën e akreditimit gjatë kësaj periudhe janë kryer: 30 mbikqyrje të rregullta, prej tyre 24 Laboratorë Testues dhe 6 Trupa Inspektuese; 8 akreditime; Është punuar në procesin e anëtarësimit në Trupën Evropiane të Akreditimit (EA), prej 32 jokonformiteteve janë përmbyllur apo adresuar 28. Janë shtuar aktivitetet e akreditimit për Laboratorë Testues, por janë shtuar edhe aktivitete e vlerësimit të Trupave Inspektues dhe numri i aplikacioneve të

trupave inspektuese është rritur për dy herë. Janë ofruar disa module të trajnimit nga të cilat kanë përfituar zyrtarët e Drejtorisë së Akreditimit, Komitetet Teknike por edhe Trupat e Vlerësimit të Konformitetit (TV); Softëare-i për akreditimin “online” DAK-SMIS është në fazën e fundit të testimit.

Në fushën e metrologjisë është bërë verifikimin dhe kalibrimin e shumë mjeteve matëse ligjore, vlen të përmenden: verifikimi i 383 pikave shitëse të karburanteve, 10 autobotëve, 13 kokave mbushëse, 1076 ujëmatësve, 499 peshoreve, 27,186 njehsorëve elektrikë. Është bërë verifikimi i cilësisë së 179,858.52 gramëve të mataleve të çmuara. Është bërë kalibrimi i 168 gramarëve dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Me mbështetjen e donatorëve është punuar në ngritjen e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë, ku janë përgatitur manualët e cilësisë për laboratorin e masës, vëllimit dhe rrjedhjes, forcës dhe termometrisë, janë përgatitur procedurat e kalibrimit, si dhe dokumente të tjera të parapara sipas standardit SK ISO/IEC 17,025. Nga maji i këtij viti Agjencia e Metrologjisë së Kosovës është anëtare e asociuar në EELMEC (Bashkëpunimi Evropian për Metrologji Ligjore).

Në funksion të përmirësimit të ambinetit të biznesit kemi bërë unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin për eksport dhe import, po punohet edhe me ATK-në që bizneset ta kenë vetëm një numër. Janë bërë përmirësime të dukshme sa i përket shërbimeve ndaj bizneseve; është shkurtuar afati kohor për regjistrimin e bizneseve dhe janë implementuar rekomandimet e task forcës” Doing Business” të udhëhequr nga MTI. Prej 3.5 ditëve sa është dashur më heret për regjistrimin e biznesit është shkurtuar afati kohor në 1.9 ditë. Janë bërë eliminime dhe reduktime të tarifave për shërbimet e ofruara për bizneset në procesin regjistrimit të tyre. Është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve, në këtë drejtim të gjitha testimet kanë përfunduar dhe sistemi ka rezultuar të jetë funksional. Është avancuar regjistri i pengut dhe ofron shërbime shumë të softistikuara sipas kërkesave të bankave.

Në fushën e inspektimit janë realizuar 892 inspektime, 77 prej tyre janë në procedurë, 365 lëndë janë mbyllur dhe janë konfiskuar 1467 artikuj. Të tregu i naftës janë bërë 409 analiza të karburantëve, janë shqiptuar 45 gjoba, janë marrë 6 vendime për mbyllje të pikave të karburanteve.

Adoptimi i standardeve: Sa i përket adoptimit të standardeve evropiane dhe ndërkombetare si standarde kosovare, janë miratuar gjithsej 759 standarde dhe 46 eurokode për strukturat: Nga këto janë miratuar 111 standarde të menaxhimit të cilësisë, janë miratuar 122 standarde për përpunim të drurit, janë miratuar 147 standarde të shëndetësisë, janë miratuar 33 standarde për makineri, janë miratuar 108 standarde të ndërtimit, janë miratuar 20 standarde për energji, janë miratuar 144 standarde për mjedis, 82 standarde për teknologji ushqimore, 29 standarde për transport dhe 91 standarde për elektroteknikë.

Është funksionalizuar Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, kontributi i MTI-së deri me tani është 2 milion euro. Poashtu me insistimin tonë ka filluar “Projekti për Çertifikimin e Produkteve” projekt ky i cili po implementohet nga BERZH-i, me mbështetje të USAID/Empoëer dhe SDC/PPSE.

Investimet e Huaja Direkte (IHD): Për peridhën janar-korrik IHD-të kapin shumë prej 122,6 milionë euro (të dhënat për tremujorin e fundit nuk janë publikuar ende nga BQK). Shtetet që kanë investuar më së shumti janë: Turqia, Zvicra, Gjermania, Shqipëria, SHBA, Italia, Austria. Është nënshkruar marrëveshja për mbrojtje dhe promovim të investimeve me Shqipërinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Aktivitet promovuese të mbajtura: Është realizuar konferenca për investime dhe tregti në Austri në bashkëpunim me Odën Ekonomike Federale të Austrisë. Në muajin maj në Prishtinë është organizuar ngjarja (punëtorja) “Austrian – Kosova Business Netëork” në bashkëpunim me Odën Austriake në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë 10 kompani Austriake dhe mbi 100 nga Kosova. Në bashkëpunim me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, kemi bashkë-organizuar konferencën “Diaspora, Investimet dhe Punësimi” mbajtur me 30-31 maj 2016 në Prishtinë. Misioni Tregtar në Amerikë në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë në kuadër të së cilës është organizuar edhe konferenca për investime në Des Moines – IOËA me 27-28.09.2016, po ashtu gjatë këtij misioni tregtar janë promovuar 10 kompani kosovare me produktet e tyre në Amerikë. Në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës dhe në mbështetje të Ambasadës së Anglisë në Kosovë, është realizuar projekti “After Care Survey” me 250 investitorë të huaj në Kosovë. Janë bërë përgatitjet për Fournin Ekonomik që do të mbahet në Londër me 03.11 dhe për Forumin Ekonomik në Romë që do të mbahet në fillim të vitit tjetër.

Mbështetja e Investitorëve të huaj në Kosovë: Janë përkrahur një numër i investitorëve të huaj të cilat kanë realizuar investime e tyre në vend.

Promovimi i eksportit dhe turizmit: Organizimi i misionëve shitëse jashtë vendit dhe brenda vendit - Si mënyrë më e avancuar e promovimit të potencialeve të kompanive eksportuese dhe gjetjes së blerësve jashtë vendit, në koordinim me të gjitha palët e interesit janë zgjedhur sektorët potencial për eksport si dhe tregjet potenciale për eksport. Gjatë kësaj periudhe MTI ka mbështetur pjesëmarrjen e kompanive tona në 12 panairë kryesisht jashtë vendit. Gjithashtu është mbështetur pjesëmarrja e kompanive vendore në 4 panairë për promovim të potencialeve të turizmit. MTI në bashkëpunim me USAID dhe kontraktuesin RECURA si dhe me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, janë duke hartuar dokumentin strategjik për 10 prodhimet më atraktive për eksport. Dokumenti do të specifikon edhe tregjet potenciale se ku mund të plasohen këto prodhime.

Më qëllim të monitorimit të implementimit të Indekseve të Politikave për NVM, janë mbledhur të dhënat nëpër institucionet relevante dhe gjatë kësaj periudhe, respektivisht me datë 02.06.2016 në Prishtinë është bërë lansimi i publikimit të OECD-së “Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016.” Nga 10 indekset e politikave, Kosova ka treguar rritje në 8 (tetë), derisa në dy prej tyre ka rënie.

Takimet me Bizneset në nivelin lokal - Qëllimi kryesor i organizimit të konferencave është fuqizimi i dialogut publiko-privat për zhvillimin e ekonomisë kosovare. Janë realizuar katër konferenca: në Podujevë, Ferizaj, Kaçanik dhe Lipjan. Jemi duke u përgatitur konferencën në Pejë dhe Gjakovë.

Ka filluar programi “Internship Biznesi 2016” - Internship Biznesi 2016 ka për qëllim formësimin e kuadrove të reja dhe bartjen e njohurive teorike në praktikë. Më 14.09.2016 është nënshkruar marrëveshja mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë.

Përkrahje ndërmarrësve të rinj - Më 09.09.2016 në Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK), MTI ka organizuar ceremoninë e prezantimit “Pitch event” e cila është pjesë e YE! Boost Program në Kosovë, një program ky për ngritjen e kapacitetit të ndërmarrësisë. Programi YE! Boost Startup, është një iniciativë e përbashkët e Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë KIESA-n, ICK, organizatën ndërkombëtare Child and Youth Finance International (CYFI), Bankën TEB dhe Fondin Evropian për Zhvillimin e Evropës Juglindore. Në këtë ngjarje tetë ndërmarrësit e rinj nga Kosova prezantuan idetë e tyre të biznesit, 8 ndërmarrësit e rinj janë përzgjedhur në mesin e 20 startup-eve të cilat kanë marrë pjesë në Ye! Boost Camp është program trajnues për aftësi sipërmarrëse i organizuar nga ICK.

Mbështetja e Zhvillimit të Zonave Ekonomike, Parku i Biznesit në Drenas (PBD): Është hartuar projekti dhe përzgjedh operatori ekonomik që do ta implementon projektin e mbikalimit dhe ndërtimin e dy stacioneve të autobusëve si dhe është duke u mirëmbajtur apo monitoruar mirëmbajtja e parkut. Janë marrë hapa konkret për zgjerimin e Parkut të Drenasit edhe për 75 ha të tjerë; ka përfunduar elaborati i shpronësimit dhe është dërguar në komunën e Drenasit për komente.

Zonat tjera ekonomike - MTI ka ndihmuar edhe tri komuna për ndërtimin e zonave ekonomike këtë vit:

- Zona Ekonomike në Shtime është mbështetur nga MTI me 58,000 Euro.
- Zona Ekonomike e Suharekës është mbështetur nga MTI me 200,000 Euro.
- Zonës Ekonomike e Lipjanit, është mbështetur nga MTI me 242,000 Euro.
- Parku Industrial në Frashër, Mitrovicë - komuna e Mitrovicës ka përzgjedhur operatorin ekonomik i cili është duke punuar në vazhdimin e punimeve për rregullimin e infrastrukturës fizike në zonën ekonomike. Nga ana e jonë janë duke u vëzhguar punimet. Lidhur me këtë fazë nuk kemi obligim financiar, pasi që MTI këto obligime i ka kryer gjatë vitit 2015.

Inkubatorët e Biznesit - Po vazhdon renovimi i Inkubatorëve të Biznesit në Bernicë dhe PBD. Është nxjerrë UA për inkubatorët e biznesit dhe së shpejti do të bëhet shprehja e interesit për inkubatorin e ICT-së në Bernicë bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe këtë UA.

Projektet e donatorëve që aktualisht janë duke punuar në mbështetje të bizneseve, promovimin e investimeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë: Fondi Kosovar për Garanci Kreditore; kontribuuesit kryesorë të Fondit, përveç financimit nga buxheti i Kosovës MTI, do të jenë: USAID, KFË, ADA, SDC, të cilët janë zotuar se do të derdhin në këtë Fond rreth 18 milionë euro; BERZH, USAID dhe SDC me projektin për Çertifikim të Produkteve; USAID – Agro mbështetje financiare për sektorin e industrisë përpunuese ushqimore; USAID – Fuqizimi i Ndërmarrjeve është duke mbështetur financiarisht projektet e bizneseve nga sektori i drurit, tekstilit dhe turizmit; UNDP; Mbështetje financiare në realizim të panairit të sektorit të

industrisë ushqimore Sëisscontact-PPSE. GIZ në realizim të projektit për ngritje të resurseve humane në KIESA. Projektet ‘Direktiva e shërbimeve në tregun e brendshëm’ dhe ‘Rritja e Konkurrueshmërisë dhe promovimi i eksportit’ financuar nga BE.

Bashkëpunimi me institucionet joqeveritare vendore: OEK, AMCHAM, PEPEKO, AKB, SHPDK.

Pronësia intelektuale, trajtimi i lëndëve-Pranimi i aplikacioneve: Agjencia e Pronësisë Industriale ka pranuar gjithsej 1291; ka shqyrtuar dhe përfunduar 1536 aplikime për marka tregtare, 177 për patenta industriale; 4813 lëndë janë në procedurë dhe për 661 aplikacione tjera ende nuk ka filluar shqyrtimi. API po punon në ngritjen e kapaciteteve të saj, në ngritjen e vetëdijes së bizneseve për rëndësinë dhe menyrën e regjistrimit të markave tregtare dhe patentave industriale. Agjencionin e kanë vizituar dy ekspertët nga EİPO, qëllimi i vizitës ka qenë skanimi i gjendjes së sistemit IPAS, identifikimi i problemeve dhe identifikimi i infrastrukturës teknike për instalimin e versioneve të reja si ai i IPAS Scan. Është funksionalizuar Këshilli Shtetëror i Pronësisë Intelektuale dhe është mbajtur takimi ku anëtarët janë njoftuar me të arriturat dhe sfidat në fushën e pronësisë intelektuale, dhe obligimet që dalin nga MSA; anëtarët janë darkoduar për hartimin e Strategjisë për Pronësi Intelektuale 2017-2021.

Bashkëpunimi rajonal e ndërkombëtar; Objektivi ynë është anëtarësimi i Kosovës në EİPO. API ka themeluar kontakt me Zyren Evropiane të Pronësisë Intelektuale (EUIPO). Kemi kërkuar që në kuadër të projekteve të IPA për 2017 të përkrahet edhe API me projekte teknike për fushën e IPR në Kosovë. Kemi vendosur kontakte bashkëpunimi me Asociacionin Ndërkombëtar të Markave Tregtare (INTA).

Aktivitete vetëdijësuese: Më 13 prill 2016 kemi organizuar debatin me temën „Të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe Sfidat që dalin nga MSA“. Së bashku me Doganën e Kosovës dhe Zyrën për të Drejtën e Autorit kemi organizur aktivitet promovues në Prishtinë, ku janë ekspozuar mallrat e falsifikuara dhe broshurat informuese për objektet e pronësisë intelektuale. Aktivitetet promovuese lidhur me rëndësinë e pronësisë intelektuale janë organizuar edhe në televizionet nacionale: RTK; Tribuna Channel dhe Kohavision; Me 10 qershor 2016, në tryezën e MSA-së të organizuar me prodhuesit e tekstilit, bizneset janë njoftuar poashtu mbi rëndësinë e të drejtave pronësore intelektuale.

Rrezervat shtetërore: Është përgatitur Plani Strategjik dhe Programi Vjetor 2016-2018 dhe i njëjti është aprovuar në Qeveri me datë 18.02.2016. Sa i përket rritjes së fondit të rezervave, fondi i rezervës shtetërore të naftës (dizel) është furnizuar me naftë në sasinë prej 117,469 litra, ndërsa fondi i rezervës shtetërore të grurit është furnizuar me grurë në sasinë prej 1,072.82 tonë grurë.

Buxheti i rishikuar i MTI-së, me Ligjin Nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 është 5,419,884 €; shpenzimi i buxhetit pas nënshkrimit të vendimit për Fondin për Garancitë Kreditore është në vlerë prej 3,423,122 milionë euro, apo shprehur në 63.16 % e realizimit. Për shpenzimin racional të buxhetit kemi marrë vlerësime shumë të larta në raportin e Auditorit të përgjithshëm. Në periudhën raportuese, nga shërbimet që MTI ka ofruar janë krijuar të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerën prej 1,815,747.12 €.

Panairot jashtë vendit dhe brenda vendit të mbajtura në këtë periudhë raportuese:

1. "Eorld of Private Label" mbajtur në Amsterdam të Holandës, në të cilën kanë marrë pjesë 3 kompani prodhuese kosovare.
2. "Green Eeek" në Gjermani në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Pjesëmarrja e kompanive nga Kosova ishte nga sektori i industrisë ushqimore
3. "Sëissbau" panairi i mobilierisë në Basel të Zvicrës. Pjesëmarrës nga Kosova ishin 4 kompani nga sektori i mobilierisë.
4. "Panairi i mobilierisë Shqipëri". Pjesëmarrës nga Kosova ishin 5 kompani nga sektori i përpunimit të drurit.
5. "Mebell 2016" mbajtur në Maqedoni. Pjesëmarrës nga Kosova ishin katër kompani nga sektori i mobilierisë
6. "Arbeits Sicherheit Schëeiz" i mbajtu në Zvicër. Pjesëmarrës nga Kosova ishin 3 kompani nga sektori i tekstilit
7. "Prishtina 2016" me 20-23 prill 2016 në Shkabaj, në të cilën KIESA ka marrë pjesë me shtand duke i informuar te interesuarit rreth shërbimeve që i ofrojmë.
8. "Made in Kosova" panair vendor i mbajtur me 2 mars 2016 për promovim të prodhimeve vendore.
9. "MOË" Bad Salzufen në Gjermani me 18-22.09.2016, në të cilën kanë marrë pjesë 6 kompani prodhuese të drurit masiv.
10. "Panairin e Produkteve Bujqësore dhe Agroindustri.ale" Prishtinë panair i mbajtur prej datës 28 shtator deri me 01 tetor 2016.
11. Panairi Seal Paris, ku morën pjesë 7 kompani nga Kosova.
12. Panairi "Gratë në Biznes" me qëllim të mbështetjes së bizneseve më pronare të gjinisë femërore dhe fuqizimit të tyre, MTI organizojmë panairin tradicional "Gratë në biznes". Panairi "Gratë në Biznes 2016" është mbajtur në sheshin Skenderbeu në Prishtinë, në datat 26, 27 dhe 28 korrik 2016, ku kanë promovuar dhe shitur produktet e tyre 60 gra ndërmarrëse nga e gjithë Kosova dhe nga pothuajse të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Ndërsa me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës si dhe angazhimit të operatorëve turistik në promovim të sektorit të turizmit janë organizuar aktivitetet si në vijim;

1. "Adventure Next Balkan 2016" në Ohër të Maqedonisë me 9-12 maj 2016.
2. "ITB Berlin" në Gjermani, prej 9-13 mars 2016.
3. "Turizmit dhe Aventurat" Prishtinë, i mbajtur prej 27-29 maj 2016.
4. "Destinations Nature" Paris, i mbajtur prej 17-20 mars 2016.

KRYETARI: Faleminderit ministre për një raportim mjaftë në detaj me shkrim që e kemi marr lidhur me aktivitetet e ministrisë, po shihet se ka pasur një punë të përqendruar në shumë drejtime dhe shumë fronte ne mund të shprehim kënaqësi d.m.th nëse ky është paralajmërim se edhe indeksi i të bërit biznes do të tregoj më mirë situatën e të bërit biznes në Kosovë, natyrisht se na mbesin shumë sfida për të punuar.

Natyrisht se ligjet aprovohen sot, politikat aprovohen sot, por efektet nuk mund të shihen menjëherë, ne duhet të matim efektet në këtë drejtim, ndoshta është mirë ti shohim shkaqet pak

a shumë investimet nuk e dimë si shkojnë, d.m.th do të sillen më pak se në vitin e kaluar ndoshta është praktik se ndonjë vit më lartë ndonjë vit më poshtë, megjithatë cilat janë pritjet e juaja për investimet e jashtme për vitet e ardhshëm ndoshta kishit mundur një përgjigje për ta elaboruar pak.

E dyta ne kemi problem me eksportin, eksporti pak a shumë nuk po rritet sa është dashtë të rritet ne duhet ti shohim analizat cilat janë shkaqet cilat janë problemet këtë drejtim ndoshta na duhet ai sektori juaj i eksportit të përcjell pak rritjen e eksportit më vjen mirë se keni hekur pengesat që kemi diskutuar më Shqipërinë natyrisht se ne kemi disa probleme ekonomike me Serbin duke filluar nga tregtia duke filluar nga eksporti kur në Serbi janë 15 milionë në Shqipëri 40 milion shumë pak ku importi po rritet më shumë, duhet ta promovojmë eksportin tonë edhe në Shqipëri natyrisht se edhe në Serbi, kemi një pjesë importi prej Serbisë që vijnë rrugë ilegale ne arrijmë atje diku 15 milionë tash imagjinoi tregun e Serbisë dhe Shqipërisë duhet ti hulumtojmë dhe të shikojmë duhet ti rrisim në nivel më të lartë interesat tonë ekonomike, për arsyeje se në qoftë se ne humbim në vit nga kodi që Serbia e pengon që pengon aktivizimin e 400 kë në mënyrë që na pengon që ne të marrim energji më të lirë ne a mundë të jem kaq hapur ndaj tregtisë ndaj Serbisë këtë drejtim ne kemi pasur bisedë tash që ishte një konferencë, ne duhet ti kontrollojmë të gjitha aspektet, ne kemi ardhur në një fazë kur Kosova duhet të përdorë reciprocitetin më shumë kjo ishte ajo që kam dashur ta theksojë, përndryshe shihet një vëllim I juaji një preokupim i juaji i rëndësishëm, ligji për investime strategjike është aprovuar që sa me shpejt ato aktet nënligjore të vëhen në veprim dhe të futet ky ligj menjëherë që të jetë me operacional pasi që ne kemi dhe një rast në Gjykatë Kushtetuese, shpresojmë që gjithçka është në rregull, por Gjykata Kushtetuese do të thotë fjalën e vet për shkak të rendësisë që kemi rritje të investimeve i'u kisha propozuar që këto të mos kenë ato afatet nënligjore.

RAIF QELA: Ministrja ka dhënë betimin se do të bëjë ndryshime në këtë ministri dhe e përgëzoj për faktin që ka nisur, mirëpo ka fusha që ka ngecje në fushën e cilësisë së karburanteve, mëndoj që nuk ka ndonjë përparim të dukshëm, është nënshkruar një kontratë për furnizim me laborator mobil, pajisja e kontraktuar punon sipas standardeve EN ISO 20 827 ky standard lejon matje prej 30 PPM deri në 500 PMM për sasinë e sulfurit në karburante, kjo i bie se karburantet që përdoren për makina nuk mund të maten me këtë pajisje si dhe vaji industrial aq më parë kur kjo është dashur të jetë. Çështja tjetër është se ju ishit këshilltare e ministrit Zharku, kur kontrollet e derivateve të naftës u bëhej përmes laboratorëve në kufi dhe ende është në fuqi i njëjti ligj që rregullon këtë fushë, është ligji për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit ligji numër 04/L-039, deklarimet tua publike ishin se do të largoni trupat inspektuese që do të bëjnë përshkrimin e analizave dhe nuk bëjnë asnjë vlerësim të konformiteti, në kufi akoma është kështu gjendja, këta trupa nuk japin llogari për send që hyjnë në Kosovë, ata përshkruajnë vetëm atë që është në letër ndërsa nuk bëhet kontrolli i karburantëve në kufi kjo është prej të metave, kur bëhen ka pak matje në kufi mundësia që të futen karburantë të dobët në treg të futet gjithmonë, të gjobiten blerësit që nuk janë importues, pavarsisht që ata nuk janë fajtor pasi që janë pajtuar që kanë marr një produkt cilësor e kanë marrë një produkt jocilësor. Kosova merr naftë kryesisht prej kompanive tregtare të dorës se

tretë ndërsa, merr edhe prej kompanive p.sh Gazpromi dhe Lukoil, që të dy duhet të kishin pasur sanksione për shkak se janë kompani ruse.

Në vitin 2015 kontrolli i cilësisë të naftës është bërë 1% e sasisë të importuar ndërsa këtë vit vetëm 0.2 % kontroll i cilësisë dhe inspektim i cilësisë në kufi, që është shifër tepër alarmante për mendimin tim. Kalimi të kontrolli i cilësisë në Doganat e Kosovës nuk ka mbështetje as në BE, as në shtetet e rajonit p.sh në Shqipëri ky kontroll bëhet 100%, nuk i masin ata një autobotë për autobotë, por e bëjnë kontrollin për të gjithë tankerin. Para importit gjithmonë në shtetet e bashkësisë Evropiane edhe në shtetet e rajonit së pari kontrollohet cilësia e pastaj lejohet të importohet, të ne është e kundërta bëhet vetëm për një pjesë të vogël e mostrave për produktet e brendshme, siç thashë në Republikën e Shqipërisë kontrollohen 100%, edhe një pjesë të madhe edhe të rajonit, pse ne të kemi kaq shumë besim te importuesit kur shpesh herë mund të bijnë edhe cilësi të dobëta, mund ti dëmtojë edhe shitësit nga karburantet lëshohen çertifikatë false të konformitetit, për këtë a keni informacion që a lëshohen çertifikata false për konformitet? Që së pari dëmtojnë konsumatorin pastaj shtetin, kurse pas kontrollave gjëbjetet kompania që nuk janë importuse, këtu krijohet një treg i pabarabartë dhe me sistemet e tilla po stimulohen kompanitë e huaja si eksportues nga vendet përkatëse.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka autorizuar trupa inspektuese për njohje dhe pranim të dokumenteve të huaja për deri sa ka ligje për pranim dhe njohje të dokumenteve, tek e fundit nuk është përgjithësi e MTI po është përgjithësi për njohje e dokumenteve të huaja sipas ligjit për njohje të dokumenteve ndërkombëtare 04/L-052, nëse nuk ka kapacitet Kosova duhet të pranohen këto trupa sipas ligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit neni 19 paragrafi 2.2 thotë se “Nëse në Republikës e Kosovës nuk ka trupë të autorizuar për vlerësim të koformitetit” ju i keni autorizuar dy trupa vetë ju, nejse ministria, si i autorizon kur importi i derivateve nga shtetet e rajonit ndërsa çertifikatat e analizave ose deklarata e konformitetit është nga Spanja ose nga Italia ose nga një shtet tjetër, si e arsyetoni se të kushtojë më shtrenjtë marrja e mostrave se sa analizë?kjo është sipas ligjit sipas standardit EN ISO 17 025 kapitulli 5.7 marrja e mostrave është kompetencë e laboratorëve e jo e trupave siç po bëhet tani. Trupat inspektuese kanë autorizim për këtë punë edhe pse është në kundërshtim me këtë standard aq më parë kur marrja e mostrave kushton më shtrenjtë se vetë analiza që është një absurd i llojit të vet.

Çështja tjetër ka me bëjë më metalurgjinë si është e mundur që MTI të lëshoj licencë për shitje me pakicë të gazit ”plin” siç i thonë serbisht, në fund të fundit deri sa paisja që e bënë kontrollin e “dispenzereve” të pikave shitëseve është ne defekt që nga viti 2011 aparati që e mat pikën matëse të gazit e ka jashtë kontrollit që nga viti 2011

(Polemik)

.....edhe asnjëherë në jetë nuk jam takuar me Fazli Berjanin, mos u nguteni të më jepni përgjigje, me ligjin për akreditim të miratuar në nëntor 2008 është themeluar drejtoria e akreditimit, deri para një muaji...

(Polemik)

....titulli zyrtar drejtor të insitucionit të akreditimit ka qenë shef i agjencisë të akreditimit, ish ministrja Mimoza Kusari e ka emëruar dhe ju ka vazhduar përsëri, madje është shpallur konkurs dhe është anuluar për fat të mirë. Meqenëse institucioni i akreditimit është drejtori e jo agjenci pse kreu i këtij agjencioni paguhet si kryeshef e jo si drejtor?

Këto ishin pyetjet e mia, sa për njoftim ju tregoj se kurrë në jetën time nuk jam takuar me Fazli Berjanin as nuk jam përshëndetur, as nuk i'a kam zgjatur dorën kurrë.

BLERIM GRAINCA: Ju përshëndes të gjithëve me ju thënë të drejtën edhe unë jam i surprizuar për të mirë me raportin me shkrim d.m.th është një qasje e re me shkrim në raport me komisionin shpresoj që në këtë frymë të vazhdohet më tutje në mënyrë që bashkërisht të gjejmë mundësi mëreferuar gjithmonë raportit dhe të dhënave që ka sjellë ministria.

Të politikat tregtare ju inkurajoj të gjithë atë që po e bëni por unë isha ndalur në raport me Republikën e Shqipërisë veçanërisht me marrëdhëniet tregtare pa dashur në asnjë moment të jem pjesë e këtij diskutimi që janë bërë turbofolk por do mundohem të mbesë në suaza të aktiviteteve ditore të cilat bëhen në bizneset kosovare, e kam ngritë edhe në ministrin e transportit.

KRYETARI: Vetëm po ju informoj që neve jemi në biseda dhe pritet që me 10-11 ti kemi këtu kolegët e komisionit, kështu që shumë qartë do i diskutojmë edhe me ta, po nuk do të thotë që edhe sot nuk munden me u theksua këtu, vetëm desha me ju informua që neve do të kem mbledhje të përbashkët dhe do të jenë këtu prezent, kështu që do të kemi kohë me u taku këtu, më falë z.Blerim.

BLERIM GRAINCA: Ju e dini z. Kryetar se kemi qenë edhe një vizitë në Republikën e Shqipërisë dhe i kemi ngritur një varg çështjesh që merren me politika tregtare por unë dua të ju informoj juve që bizneset kosovare kohëve të fundit veçanërisht ato që merren me eksport po ballafaqohen me probleme të natyrave teknike të cilat e vështirësojnë eksportin veçanërisht kompanitë që eksportojnë mallra në Republikën e Shqipërisë gjegjësisht maunat e tyre të cilat kalojnë në Republikën e Shqipërisë për arsye të një vendimi që ka marrë Republika e Shqipërisë vendim të ja kontrollojë maunat të cilat futën në Republikën e Shqipërisë. E di së mund të më thoni se praktika të tilla ka edhe nëpër Republika të tjera që marrin vendime të tilla por në këtë raste unë ju them se e përbëjnë një politikë të reciprocitetit dhe nëse ata marrin një vendim. Qeveria e Shqipërisë me 31.07.2015 merr një vendim që të gjitha maunat të cilat eksportojnë apo autobusëve të cilët kalojnë në Shqipëri tua mat sasinë e naftës a kanë rezervar dhe ti obligojë që të marrin naftë në Shqipëri, ku nafta është më e shtrenjte se në Kosovë, pyetja ime është se a po aplikojmë reciprocitet të tillë dhe a duhet ta bëjmë? Po ashtu edhe tek politikat tregtare më intereson pjesa e aplikimit për organizim në Bankën Botërore të tregtisë ka mëndoj se kemi mbetur në suaza të dëshirave me sa unë e di, dhe do të doja të di se a është duke u

punuar në këtë drejtim deri ku ka arritur, i dimë pengesat që janë të natyrave edhe politike por do të ishte mirë që ti anulojmë këto.

Të promovimi i investimeve veçanërisht tek Fondi për garancitë tregtare më intereson ta dijë se deri ku është arritur sa është bërë funksional a ka filluar? Cili është efekti funksional, cilat janë kërkesat e bizneseve edhe a është në rregull mënyra e këtyre kërkesave? Po ashtu edhe tek mbështetja e investimeve të huaja një varg aktivitetesh që keni pasur ju inkurajoj por unë do të doja të di se a ka takime dhe biseda direkt të investitorëve të huaj për strategjinë sidomos tani pas miratimit të Ligjit, çoftë investitorë të cilet janë lajmëruar më herët çoftë tani a po bisedohet me ata sepse këtu promovimi i këtyre takime apo tryezave, nuk jam shumë pro tyre sepse janë treguar jo shumë produktive, prandaj bisedat kokë më kokë janë më të suksesshme. Të promovimi i eksportit znj. Ministreshë, unë do ju kisha dhënë një sugjerim apo rekomandim pasi që tani jemi në fazën e miratimit të buxhetit, por unë mendoj se do ishte mirë që ti rregullon edhe me Ministrinë e punëve të jashtme në kuadër të Ambasadave të cilat i ka Republika e Kosovës jashtë, në suaza të politikave ekonomike apo politikave tregtare të instalohen atashe ekonomik, apo persona të cilët merren me probleme ekonomike për arsye se jemi dëshmitarë për Ambasada tona ku shumica e stafit që është atje përveç që nuk kanë lidhje me ekonominë edhe me biznesin dhe të berit biznes, pak prej tyre kanë lidhje edhe me diplomacinë, dhe unë ju inkurajoj që së bashku me Ministrinë që të futeni edhe një buxhet që në kuadër të ambasadave të instalohen....

Më intereson edhe parku i Drenasit, kalaja e Rozafës, që disa vite po përcjellët mese kur do të përfundojë si proces më të gjitha zgjerimet të cilat po bëhen për të gjitha punët e mira të cilat po bëhen aty unë ju përgëzojë por mua më intereson të dijë se deri kur do përfundoj-mbyllet apo deri kur do shkojë me zgjerime dhe ju përgëzojë për trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me shpronësinin e lënëve të gjetura, dhe në fund është çështja e buxhetit. Neve e dimë se MTI-ja e ka pas një buxhet 5 milion e diçka që është shumë më e vogël se vetë buxheti që ka RTK e Kosovës, që i kemi dhënë rreth 10 milion, dhe ju inkurajoj që të insistoni në rritje të tijë në çoftë se nuk ju mjafton në mënyrë që buxheti që do ketë MTI-ja të mjafton për realizimin e objektivave të saj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pikërisht një nga arsyet pse ne po bisedojmë është që ti parashtrojmë dhe ti shohim të gjitha këto gjëra për së afërmi dhe të diskutojmë se çka duhet të bëjmë, që pikërisht të gjitha aktivitetet e ministrisë, mandej dy rezultatet, rritja e investimeve të jashtme, rritja e eksportit edhe rritja ekonomike kuptohet, tre tregues në fund na dalin sintetik, fjalën e ka kolegu Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Problemi kryesor lidhur me ekonominë dhe tregtinë rrjedh prej doktrinae ekonomike edhe koncepteve që kanë aplikuar qeveritë e deritashme të Kosovës në fushën e ekonomisë dhe të tregtisë edhe problemi më i madh të cilin e kemi pasur si shtet ka qenë se si e konceptojnë mbledhjen e të hyrave dhe raportin e të hyrave Qeveria në raport me ekonominë dhe zhvillimin ekonomik.

Si rrjedhim e kemi pasur një fokusim të jashtëzakonshëm të mbledhjes së të hyrave në doganë që përbënë shumicën e përqindjes së të hyrave në buxhet në doganë dhe kjo kryesisht nga importet dhe gjithmonë kemi hyrë në atë ciklin vicioz të rritjes së vazhdueshme të importeve si interes i Qeverisë për me vjel sa më shumë të hyra, në vend për ta pasur një koncentrim më të madh ekonomik të Qeverisë në vjeljen e të hyrave prej tatimeve në fitim prej hapjeve më shumë të bizneseve nga rritjet e vendeve të punës që është d.m.th një doktrine tjetër. Juve kur keni qenë si deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mandatin e kaluar e keni kritikuar këtë tendencë të qeverive të atëhershme, por sot duke qenë në postin të cilin juve e mbani ku keni përgjegjësi në ekzekutivë dhe përgjegjësia është konkrete ju nuk keni arrit aspak me e ndryshuar këtë diskurs negativ i cili gjindët Kosova, pra problemi më i madh është deficitit tregtar që e kemi.

Deficiti po rritet, deficitit është duke u rritur edhe gjatë kohës kur juve e keni marrë postin e Ministres pra nuk ka reduktim të deficitit në Kosovë. Importet në përqindje në krahasim me eksportet rriten shumë më shpejtë se që rritet pjesëmarrja e raporteve në buxhet edhe në GDP-ia edhe në këto tjera, por unë mendoj së drejtimin ekonomik Kosova nuk e ka ndryshuar as pak që nga viti 2001 vetëm ka shkuar në atë drejtim por në vitin 2014 d.m.th kur Qeveria e juaj ka ardhur me premtime që do ta ndryshojë këtë diskurs mirëpo unë mendoj që nuk kamë parë asnjë indikacion që këta parametra të janë ndryshuar, edhe 50 vjet nëse e udhëhiqni Kosovën kjo ka me vazhduar në këtë mënyrë ky deficit duke u rritur vazhdimisht. Unë mendoj se na nevojitet një drejtim i ri jo siç kemi parë deri tash. Këtu na lenë neve ma marrë vesh që partnerja tregtare kryesore ekonomik e Kosovës në rajon është Serbia. mendoj që kjo është e gabueshme natyrisht që nuk po dua të ju bie në qaf për këtë sepse nuk jeni ju shkaktarja, në fakt i kësaj pune këtu ka rrethana shumë më të hershme, mirëpo na vijmë në pozicionin ekzekutiv duke i pasur parasysht disa gjendje ekzistuese, d.m.th nuk jeni shkaktarë të atyre gjendjeve, por vijmë aty për me u përballë me atë gjendje të cilën e gjejmë aty dhe të cilat nuk i kemi krijuar vet por puna jonë matet me atë se sa kemi arrit me i ndryshuar atë gjendje të cilën e kemi gjetur hazër dhe të cilat nuk i kemi shkakuar më herët. Dhe, fatkeqësisht nëse e shikojmë atë raportin e tregtisë me Serbin siç e përmendi edhe profesori më herët në mes të 300-400 milion eurove e cila është tregti legale por me qenë se në atë pjesën veriore kemi zhvillim të aktiviteteve përmes kontrabandës edhe hyrje ilegale të mallrave, që është njëfarë tregtie ilegale pjesëmarrja e shkëmbimit të mallrave të Kosovës dhe Serbisë paraqet një problem shumë të madh jo fortë në kuptimin ekonomik – tregtar, por në kuptimin politik sepse unë mendoj që nuk mundet një institucion i Republikës së Kosovës apo një ministri me thonë që mua nuk më intereson se ku po shkojnë parat e Kosovës. Mua po më intereson se ku më së shumti qytetarët e Kosovës po i qojnë parat e tyre dhe kjo është një problem apo përcaktim se ka po don me ja dhënë... cilët do të jenë partnerët kryesorë të Kosovës.

Për mua do të kishte me qenë shumë e çuditshme p.sh po të kishte pasur politikë me shtetet e Bashkuara të Amerikës me qenë bashkë partner kryesor i tyre Irani edhe Rusia, kjo nuk mund të ndodhë, kjo është përcaktim edhe politikë pak me kënd do të bësh shkëmbime, me ata me të cilët ke probleme politike me ata me të cilët ke konsekuenca në kuptimin e sundimit të Ligjit, në

kuptimin e sovranitetit duhet një orientim i politikave tregtare edhe ekonomike edhe unë këtë nuk e kam parë në Qeverinë e Kosovës ku edhe një pjesë e përgjegjësisë bartet edhe tek ju.

E treta desha me i ngritë punët e brendshme në Ministri sepse nuk u folën fare dhe nuk u ngritën nga askush. Auditori ka vërejtë që ju jeni prej Ministrive ma problematike në kuptimin e riorganizimit të stafit dhe risistemimin e njerëzve d.m.th ju prej të gjithave ministrive ju jeni më e përmendura në këtë drejtim. Auditori thotë që katër lënde janë në komisionin disiplinor, 59 në komisionin e për zgjedhjeve dhe ankesave, 23 në Këshillin e Pavarur të Shërbimit Civil. D.m.th ka sidomos vërejtje për harmonizimin e koeficienteve lidhur me pozitat përkatëse, numrin e pa harmonizuar të punëtorëve në departamente edhe kompensimet e shtesave dhe të pagave të cilat nuk kanë qenë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. A mund të na jepni shpjegime në këtë drejtim? Tjetra ka pasur edhe vërejtje lidhur me favorizimin e punësimeve partiake sikurse siç është rasti i z. Xhemajl Sylës, i cili u fut në listën për kuadro por u suspendua për shkak të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Tjetra dëgjuam të gjitha ato raporte e shpjegime por ajo e cila mundet të ju bie në sy të gjithëve është se po marrim pjesë në këtë diskutim asnjë fjalë për Brezovicën, ku Brezovica është një prej çështjeve më të rëndësishme në Kosovë. Ka pasur shumë premtime lidhur me këtë drejtim, lidhur me një strategji për Brezovicën se çka do të ndodhë me Brezovicën dhe si është e mundshme që ju e bënë një raport për vitin 2016 në Komisionin tonë dhe asnjë fjalë nuk flitet për Brezovicën. Ne duam ta dimë se çka ka ndodh me Brezovicën, në anën tjetër duhet ta keni parasysh që Marko Gjuriqi që është përfaqësues i zyrës për Kosovën në Serbi, ka bërë shumë punë të dëmshme dhe e ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë këtë proces dhe ju ka shkruar letër investitorëve edhe e ka ndaluar krejt procesin. A ju keni shkruar edhe ju letër investitorëve për me ndalu d.m.th këtë farë fushate për Trepçën, por edhe për Brezovicën? I ka ato konceptet e veta që janë plotësisht në kundërshtim me tonën dhe janë në luftë të hapur me konceptet tona d.m.th ata e konsiderojnë këtë si pronë të vetën, ata gjithmonë dëshirojnë ta dëmtojnë Kosovën në këtë drejtim.

Edhe e fundit është kjo që thatë ju lidhur me investimet shikoni unë lexova dhe këtu raportet e Kosovës, por edhe raportet ndërkombëtare edhe të BQK për Kosovën sa i përket ajo e të bërit biznes si përket ajo të marrëdhënieve të jashtme dhe zbatimin e kontratave në përgjithësi. P.sh atë thuhet sa i përket Kosovës në raportin e të bërit biznes për Bankën Botërore për vitin 2016 nëse nuk gaboje Kosova renditet dy pozita më poshtë se sa vitin 2015, kështu po thotë raporti kjo është pozita më e ultë duke marrur vendet e rajonit si Malin e Zi, Maqedoninë, Serbinë e kështu me radhë. Edhe Serbinë edhe Shqipërinë, bile Kosova renditet e fundit, dhe Kosova kalon 6 vende sa i përket çështjes e rrjetit elektrik. Ju e dini se kjo është për zhvillimin industrial kjo është shumë problematike, nuk ka zhvillim industrial pa u plotësuar qasja në burime sidomos në energjetik. Sa i përket zbatimit të kontratave gjendja në Kosovë thotë se është përkeqësuar dhe qëndron më keq se sa shumica e vendeve fqinje, ka ende shumë të madhe të sasisë së fuqisë punëtorëve e kërkesa të tregut si dhe nuk ka një d.m.th. strategji kombëtare sa i përket lidhjes të arsimit dhe të edukimit, se si përkthehet ajo në zhvillim ekonomik dhe në prodhimtari më të madhe. D.m.th. sa i përket investimeve të huaja direkte ju e kishit informatën deri në korrik të

këtij viti d.m.th. për 6 mujorin e parë unë e kam informatën deri në qershor të viti 2016 d.m.th. janar qershor 2016 këtu po thotë vetëm deri në qershor 97.5 milion euro, dola dhe shikova statistikën e viti 2015 e njëjta për vitin 2015 janar qershor 136 milion euro, këtu ka një rënje të këtyre far investime, që nuk po e di a është a i përket ciklit që foli profesori apo mos është ndonjë përkeqësim më i madh në sundimin e ligjit apo të drejtësisë, apo kur investitorët shohin kesi si po ndodh me Nuhi Uken edhe më këto krejt tjera nuk janë në kompetencën tonë. Edhe po ashtu këtu nuk po dua mu ndal te hapja e ndërmarrjeve sa hapen sa mbyllen ndërmarrje nuk e di sa tregon kjo mirëpo 448 ndërmarrje janë mbyll më shumë në të njëjtën periudhë kohore....

(Polemik)

KRYETARI: Këto çështjet e i kam vetëm një situatë që ne kemi mbërri. Gjuriqi flet diçka, Vuçiqi flet diçka, krejt Kosova çohet në këmbë ju bëhet shumë popullarizim atyre...

(Polemik)

.... nuk jam i sigurt që problemi kryesor i Brezovicës natyrisht në qoftë se ai funksionon ashtu duhet ti sanksionojmë ato sjellje nuk mendoj që shkak kryesor ka qenë Gjuriqi për Brezovicën vetëm nuk duhet ti nënçmojmë kanë ndikim por janë disa çështje më esenciale sepse Vuçiqi ata bëjnë punën e tyre kanë për tu munduar ta penguar Kosovën në natyrisht se ata duhet të sillen nëse dojë ti përmirësojnë marrëdhëniet me Kosovën dhe duhet të sillen ndryshe edhe ti sanksionojmë, pasi që e kemi shumë vështirë të shikojmë se çfarë thotë Vuçiqi apo Gjuriqi.

RRUSTEM BERISHA: Unë së pari, është bërë një praktik e mirë që ta kemi raportin me shkrim për këto takime, mendoj që duhet të vazhdohet me këtë praktik jo si herës se kaluar nuk e kemi pasur këtë mundësi të kemi një raport....

(Polemik)

....nuk ka të bëjë më juve unë pa dashtë me i përsërit disa gjëra që u thanë më herët ajo që po më intereson ka të bëjë me çështjen e rregullimit të naftës u thatë se që në Kosovës sipas databazës që e keni janë gjithsesi 859 pika karburanti, ajo që po më intereson mua ka të bëjë me pikat e karburantit që janë në Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan, Mitrovicë e Veriut, se me çfarë licence punojnë ato edhe kur do ti marrin licencat e ministrisë tonë ose kur do të marrin masa adekuate ata që nuk i marrin për tu mbyllur veprimtaria e tyre kjo është çështja e parë. Çështja e dytë ka të bëjë me kontrollin e cilësisë së derivateve, sipas burime që kemi trupat inspektuese që janë në kufi nuk e kontrollojnë cilësinë në shumicën e rasteve por vetëm letrat dhe shumica e derivateve në Kosovë hyn pa u kontrolluar cilësia e naftës. Çështja tjetër ka të bëjë me kalibrimin e pompave që shesin gaz ose agregateve, ka shumë agregatë në Kosovë që shesin gaz pa kalibrimin edhe kur do të ndalet kjo veprimtari pse ju lejohet diçka e tillë. Çështja e tretë ka të bëjë me prodhimet vendore cila është strategjia ose cilat janë politikat e juaja që do ti merrni për stimulimin e prodhimeve vendore edhe për mbrojtjen e tyre tek ne. Ju faleminderit.

FATMIR REXHEPI: Personalisht mendoj që vlerësimi që ka bërë ministria dhe në veçanti ministrja në krye të saj me dy raportime në komision është për mendimin tim pajtim plotë me ato aktivitet që i tha këtu dhe duhet ti japim një përkrahje të plotë për shumë arsye. Pasi që me shumë politika që këtu i ka zbatuar ka ndryshime që në vitin tjetër pra të ecin shumë më shpejtë në realizimin e këtyre objektivave që i ka shtruar edhe në fund të sajë edhe në ato të parat që i ka jep më herët, andaj po i jap përkrahje të fortë.

Shpesh herë po e përmendim paranë publike, jemi mësuar të kritikojmë edhe paushall dhe.... edhe me fakt ndonjë herë natyra se si ministrja edhe të tjerët se si i menagjojnë paranë publike në këtë rast, unë duhet të them vetëm fjalë të mira për korrektësinë për përkushtimin dhe atë që ka bërë ministrja për menagjimin e parasë publike. Sa i përket buxhetit natyrës të shpënzimit punëve, aktiviteteve, cilat janë financuar nga vlerësimi që ka dhënë auditori edhe nga ajo që nuk kemi parë asnjë shenjë asnjë sinjal..... unë po ashtu e vlerësova edhe raportin pozitiv që u tha lidhur me pikat që u shtruan këtu, kur kemi me pronësinë industriale është e vërtetë që ka qenë një problem shumë i madh ka qenë një vlerësim kritik, po këtu në komision për të gjitha ato lëndë që janë grumbulluar më herët dhe tani janë në rrugë të zgjedhjes të dhënies atyre përfundimeve të ministrisë që kanë qenë me mijëra lëndë por që do të thotë që është një volum i madh i punëve brenda njësisë që janë bërë që shkojnë në favor të kërkesave, që janë shtruar bizneseve kjo duhet shtruar parasysh.

Sa i përket mbikëqyrjes të tregut mendoj se atë ka vend të shikohet dhe të punohet më shumë edhe inspektorati të jetë në nivel të detyrave të veta non-stop të punohet pasi kjo ka ndikim të madh në konkurrencën në treg të luftojmë të gjithë infuzionin në lamin e fushës së ministrisë të tregtisë dhe industrisë kur është pyetje konkurrenca, cilësia dhe gjërat tjera që dihen njerëzit ti bëjnë, mendoj që këto kuadrat duhet të ecin më shpejt, ajo që për mua është e natyrës më brengose ka qenë efekti i zonave industriale dhe parqeve ... në Kosovë nuk mendoj që ka dhënë atë rezultatin e pritshëm të investimeve në këto zona ekonomike, nuk kanë mundur ti realizojnë mirë, nuk kanë të bëjnë vetëm në këtë ministri, po prej ditës së parë që sa vite me dekada në Kosovë, mendoj se kemi çaluar nuk kemi mundur mirë ti organizojmë mirë zonat industriale me qenë në funksion vërtetë të investimeve, çoftë vendore, çoftë të huaja me krejt infrastrukturën përkatëse, që duhet cilin do vend që marrim për krahasim, mendoj që kemi mbetur mbrapa kjo është një faktor edhe me koston e prodhimeve të cilat pastaj nxjerrën nga prodhuesit vendor për të mundur të kemi një potencial të madh drejt eksportit, mendoj që këtu duhet të bëjmë shumë më shumë sa përket kësaj është një potencial i madh i prodhimeve vendore i cili kish për të ndikuar në formulën kryesore që u përmend nga kolegët problemi kryesor deficiti tregtar, të gjithë ata që merren me jetën ekonomike të këtij vendi politika kryesore e cila duhet të fokusohet e gjithë Qeveria dhe shoqëria jonë se si të emërtojmë ato, të sfidojmë këtë deficit në treg përmes prodhimeve vendore që në mënyrë që të kemi eksport ta ndryshojmë atë defekt mes eksportit dhe importit që është keq....e lehtë është të flasim por vështirë të realizojmë në çoftë se ka diçka se ka pasur pengesa ose defekte që nuk kemi mundur të ndihmojmë se cilat kanë qenë përparësitë në infrastruktura në energjetik në ambientin e përgjithshëm ekonomik po marr shembull siç janë Maqedonia, Serbia apo Turqia, që kanë mundur të nxjerrin kosto më të mirë

të produkteve të tjera që kanë mundur ti eksportojnë në tregut e tjera, mos është kjo një faktor që ka ndikuar përveç asaj pjesës që ka ndikuar ti takojë biznesit çoftë prodhimeve bujqësore të jetë sa më produktiv e tjera që është hallka e dytë e faktorit që e bënë koston e prodhimit për të qenë konkurrent në treg këtu duhet të hulumtojmë sa më shumë në të ardhmen që ky potencial të shndërrohet në eksport duhet të mendoj mirë qeveria ashtu qysh ka vepruar të veproj të ardhmen çofte me Maqedoninë, çofte me Turqinë kur janë në pyetje politikat e reciprocitetit ka të bëjë vetëm me një vend mendoj se këtu duhet të bëhet politika e nivelit nacional dhe çka e lejon standardet e ekonomisë bashkëkohore.

Mundësinë që qeveria me politiken e vet që mos të krijoj monopol por realisht me mbrojtur atë që duhet të mbrojtur që e bëjnë edhe vendet e tjera ta marrim Maqedoninë të shikojmë në faza të caktuara se si ka vepruar, si i ka mbrojtë ato ose ndonjë vend tjetër, ta shohim na se kur kemi humbur kohë por në të ardhmen është mirë në kohë se kjo po ashtu po ka dëme të mëdha në jetën ekonomike në atë si të themi ndikimin e madh në impakt që ka kjo në produktet vendore. Mendoj se reciprociteti duhet të mbahet për herë por duhet të implementimet në momentin e duhur thash që nuk është vetëm Serbia, është edhe Turqia, që ka ndikim të madh, edhe Maqedonia është që në sezone të caktuara në kohë të caktuar, të cilat pastaj po ka profite të mëdha dhe produktet tona, po kanë humbje të mëdha në pamundësi të eksportojnë. Mendoj se janë disa hapa që na presin por nuk janë të lehta por duhet ti kemi si politika si strategji që, mendoj se ministria i ka parasysh por duhet ta ketë përkrahjen e plotë të Qeverisë, të Kuvendit dhe mendoj që duhet të ketë përkrahjen tonë të plotë.

BESIM BEQAJ: Ne diskutuam shumë çështje teknike që besoj që janë në interes, edhe e falënderoj ministren për raportin e shkruar i cili tregon një aktivitet të ngjeshur të ministrisë dhe që tregon që ka një angazhim edhe kohor edhe material edhe në kuptimin e tendencës profesionale për ti shtyrë gjërat përpara.

Më të thënë drejtën kalova nëpër raport dhe nuk gjeta të dhëna të cilat parimisht është dashur të gjinden ministria e tregtisë dhe industrisë është e thirrur sipas emrit të saj të merret me trajtimin e tregtisë dhe industrisë. Nëse shkojmë nëpër raport fillon me integrim evropian që është jashtëzakonisht që është i rëndësishëm, shkojnë të politika industriale një pasus i shkurt që nuk e tregon gjendjen tregu i naftës, kontrolli mallrave, mbrojtja e konsumatorëve, akreditimi, regjistrimi, standardizimi, janë promovim i eksportit, me një fjali që tregon sa kanë qenë eksportet dhe vazhdon pastaj me formën industriale dhe shpjegon legjislacionin pra nuk e reflekton raportin emrin e ministrisë. Sipas këndvështrimit tim, unë kam pritur se sot në raport, cilat janë gjendja e tregtisë sot e Kosovës në raport me shtetet tjera, cila janë trendet e tregtisë sa janë ato eksportet, të cilat në krahasim me viti paraprak janë zvogëluar nëse e shohim byronë e eksportit të raport në gushtin e vitit 2016, me gushtin e 2015, e shohim një mbyllje minimaliste është diku 7. Diçka në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë 12% mbyllja. Pra nuk kemi të dhëna të cilat na tregojnë gjendjen e tregtisë që e kemi as nuk kemi informata për bilanc tregtar që është punë e drejtë për drejtë e ministrisë, as nuk kemi sa janë eksportet si janë duke përfomuar ato dhe cila është struktura e eksporteve a po ndryshon ajo në të mirë të aktiviteteve që kemi bërë apo nuk po ndryshon, as një informata e vetme nuk mund ta gjejë, cilat janë

perspektiva dhe qysh është ka përformon importi si janë duke përformuar investimet e juaja të drejtpërdrejta. Ju na keni dhënë një shifër 122 milion që janë në një përudhë kohore, mirëpo, nuk na keni dhënë një trend të përformimit të tyre ne duhet të krahasohemi me diçka kur flasim për aspekte tregtare.

Pjesa tjetër kur unë kam pritur të reflektoj është industria jo ta trajtojmë vetëm pronësinë industriale, mirëpo kam pritur cilat janë industritë të cilat janë aktualisht më të zhvilluara në Kosovë, cilat industri kanë perspektive për eksport sa prej tyre industrive i keni përkrah nëse keni rrit konceptin e eksportit. Kam parë përshkrim të detalizuar të gjitha konferencave përkrahjes nëpër pjesëmarrje në panaire dhe natyrisht duhet të na jepet një informatë se a kanë pasur efekt këto panaire këto pjesëmarrje cilat janë, pra duhet të orientohemi në industrinë e përpunimit të drurit apo te metalit, apo ndonjë shërbim, apo në tekstil? Nuk e kemi asnjë informatë të vetme në raport, dhe tash mbi bazën e kësaj nëse ne flasim për legjislacion nëse flasim për punë operative, u pa edhe në raport u bënë shumë detaje nga këndvështrimi i derivateve të naftës siç thanë kolegët e nderuar, por unë mendoj se ministria e tregtisë dhe industrisë, duhet të na jep një pasqyrë më se pari të tregtisë të raporteve të perspektives tregtare, perspektives të eksporteve çfarë ka bërë këtu kemi një disproporcion, po them shumë hapur të investimit të kohës dhe të parasë, që ne po shohim nëse shohim se sa kemi investuar se kohë dhe para për konferenca, për përkrahje të panaireve, do të ishte mirë të kemi një kundër bilanc të shohim se sa këto kanë dhënë efekte. Unë në këtë drejtim kam pritur ta kemi debatin sepse nuk është fort problematike.

Çështjau përmend çështje e metalurgjisë, është çështje e cila është e standardizume është një zyrtar, dy zyrtar që duhet ta kryejnë neduhet me pa aspektet strategjike të funksionimit ministrisë dhe politiken zhvillimore të qeverisë të cilat paraqiten përmes një ministre, mendoj se kjo si informatë duhet të përmirësuar substancialisht kjo është informatë, ndoshta e stafit të cilit duhet ta trajtoni për brenda, por jo me deputet, sepse janë punë teknike të cilat nuk na interesojnë fort. Neve na intereson se ka është ka shkon nëse është tu ra, pse është tu ra, nëse kemi ngritje cilat janë punët kemi bërë në ngritje, nëse kemi rritje të deficitit tregtar pse po na ndodh deficiti tregtar, cilat janë arsytet që po na ndodhin në rritjen e deficitit tregtar. Këto janë gjëra që besoj se duke vlerësuar punën e ministrisë, po edhe duke plotësuar raportin me shkrim kjo na ndihmon të japim kritika më të fokusuara. Besoj se kjo shkon në lexim, besoj se në të ardhmen duhet të jemi shumë më të koncentruar në punë sepse kjo është çështje e kabinetet tuaj, puna juaj që krijimi i politikave jo zbatimit të përditshëm, krejt këto lidhen me sekretarin me gjëra tjera në mënyra të përditshme. Faleminderit.

ENVER HOTI: Pajtohem me shumicën e çështjeve që u ngritën nga parafolësit, nga deputetet ngase mendoj sepse do ti ndihmojnë ministres për ti marr masat e duhura për ti kryer detyrat e saja, unë do te doja qe ne ketë raport te shohim për zonat industriale, ku janë efektet e tyre, janë ngritur dhe vazhdojnë ende te ngritën dhe te investohet ne to kurse efektet nuk po i shohim askund, a do të vazhdohet ende te krijohen ende te krijohen zona te tilla me te cilat do te krijohen shpenzime. Mirëpo efekti i tyre dhe rezultatet e tyre janë mos te themi zero me përjashtim te asaj infrastrukture që ndërtohet aty, për hapje te vendeve te punës për zhvillim te

tyre efekti është zero apo do të jemi prapë ne një situatë të tillë që për efekte elektorale mund të hapim edhe nëpër qendra të tjera.

Pyetja tjetër është, kisha pas dëshirë këtu të shohim për investimet e jashtme, një të dhënë dhe disa shkaqe pse ka rënie, pse nuk jemi ne raport se paku me regjionin me shtetet fqinje, cilat janë ato elemente apo shkaqe për të cilat ne nuk kemi investime të jashtme?

Nuk do të duhej të ndalemi vetëm në shifra që tregojnë rënien ose ngritjen por cilat janë elementet ose pengesat që kanë rënë këto investime dhe do të doja të dija masat të cilat do ti ndërmerreshin që ne të krijojmë investime të jashtme, ajo çka me bëri përshtypje është se dëgjova nga një parafolës këtu se kemi mungesë të kuadrit të ekonomisteve nëpër ambasadat tona, pajtohem plotësisht me të por ajo që nuk kemi një staf kompetent në stafin diplomatik. Ju çdo ditë po vendosni ambasadorët dhe diplomat, është shqetësuese për shumicën e juaj dhe Qeverinë, sigurisht mua po me shqetëson shumë kjo e dhanë pikërisht sepse po dëgjohet nga vet një komponent i shumicës dhe siç është mendoj se duhet ti ndërmerrni disa masa.

SALA BERISHA-SHALA: Përsëritet ministere, të përsëritet për këtë raport se paku që je e para që na sjellë në formë të shkruar pa marrë parasysh a përfshihen detale apo jo, ne kemi një bazë mbi të cilën po diskutojmë, dëshiroj të them që secili por edhe ju nuk duhet të prisni, secili mund të thotë puna e marrë, je ka punon mirë por duhet me i prit edhe vërejtjet edhe sugjerimet, me marr me qetësi edhe sa i përket kësaj korniza profesionale varet nga këndvështrimi i secilit veç e veç dhe mbi të gjitha kritikën e shëndosha janë të mirëseardhura për secilën anë.

Shumë çështje që u ngritën këtu veç se u përmenden nga koleget e mijë deputet, edhe për mua çështje e rëndësishme është turizmi, Brezovica, dhe këtu kërkoj më në detaj me na dhënë informacione sepse këtu lidhen edhe investimet e huaja, u përmenden edhe kostot industriale që me theks të veçantë i përmendi kolegu Grainca, parku i biznesit në Drenas. Dëshiroj me ditë se ju thatë që i keni dërgua elaboratin e shpronësimit dhe e keni dërguar në Komunën e Drenasit për komente, a është ndonjë afat për dhënien e komenteve? Sepse me intereson se çka do të ndodh me pjesën tjetër në anën e kundërt që për momentin është përballë parkut të biznesit në Drenas. Tjetër të investimet e huaja e keni përmendur në raport në faqen 7, shumë miliona për tre muajt e fundit dhe keni përmendur shtetet që kanë investuar me se shumti, Turqia, Zvicra, Gjermania, Shqipëria, ShBA, Italia dhe Austria, kisha dashtë me ditë në çfarë segmenti kanë investua këto shtete, në çfarë fushe, cili segment është tërheqës për investime të huaja në këto segmente?

Kolegët përmenden që ka rënie të investimeve të huaja por shpresoj unë shpresoj që me një bashkëpunim dhe bashkërisht ne duhet të punojmë në këtë drejtim që të joshim me shumë investitorë të huaj. Të mbrojtja e konsumatorit faqe 5, njërin nga aktivitetet e keni përmendur edhe marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën jo qeveritare “Konsumatori”, dëshiroj me në detale me ditë se në çfarë cilësie në çfarë kuptimi e keni nënshkruar këtë marrëveshje, dhe a është kjo organizate, a ka shtrirje në tërë Kosovën dhe sa ka staf? Mbrojtja e konsumatorit mendoj që është një çështje shumë e rëndësishme dhe nuk është e mjaftueshme vetëm në ditën e

mbrojtjes së konsumatorit me bërë fushata por ti propozohet edhe Ministrisë së Arsimit, që të ketë ndoshta dhe të futet në arsim një kapitull i veçantë në lëndë të ndryshme sepse jemi dëshmitar të asaj dhe shohim çdo ditë se çka ndodh me mallra të ndryshme dhe kështu me radhë.

KRYETARI: Neve këtu po bisedojmë që me i shty gjerat përpara dhe besoj se këtu ishim të gjithë të “intonuar” diskutimet pa marr parasysh që ndonjë nenthekson ndonjë gjë më shumë apo më pak, por mendoj që kjo është një nga mbledhjet që patë një diskutim shumë përmbajtësor dhe konstruktiv, dhe në atë drejtim ne e dimë që natyrisht që inistrja është përball me shumë me një situatë shumë të vështirë i ka ditë gjërat përpara, po shihet shumë punë por ajo që diskutuam këtu ishin disa përqendrimë disa çështje kyçe ku duam ti shohim rezultatet dhe disa informacione shtesë, andaj po ta japim fjalën Ministre natyrisht që edhe ju kur keni qenë deputete diskutojshe por tani je edhe ministre, edhe deputet, prandaj parashtrojmë pyetje që ndoshta duken pak më të vështira por ky është roli i Kuvendit për me mujtë me marrë përgjigje sa më të sakta. Urdhëro znj.ministre.

HYKMETE BAJRAMI: Unë dua të them se qasja ime absolut nuk ka ndrru ndaj atij pozicioni kur kam qenë deputete, d.m.th koncepti dhe qasja është e njëjtë të cilën e kam pasur. Po fillojë me përgjigje një nga një.

E para kisha filluar fillimisht me projektin e Brezovicës, ku kërkoj këtu e diskutuam me kolegët që na ka ikur dhe nuk kemi raportuar për Brezovicën dhe është bërë d.m.th pa kurrfarë qëllimi, dhe ju e dini se është gjithçka e njohur sa i përket procesit të Brezovicës, është një proces të cilën unë e kam gjetë aty dhe nuk e kemi vazhduar për shkak të mos përmbushjes së kontratatës financiare, obligimeve financiare, në kërkesë të investitorit ku ne e kemi zgjat një afat prej gjashtë muaj, prap pas gjashtë muajve nuk është arrit që të përmbushet oferta financiare. Dhe kemi marrë vendim si komitet ndërministror që të shkëputim kontratën. Prej kësaj kontrate normalisht që nuk ka qenë një lajmë i mirë Qeveria i ka përmbush të gjitha obligimet sa i përket asaj sepse në të dyja anët në dy afatet gjashtë mujore ka pas obligime neve qysh në gjashtë mujorin e parë kemi përmbush të gjitha obligimet sa i përket vendimeve të shpronësimit dhe gjithçka tjetër thjeshtë tenderi ka dështua për shkak të mos përmbushjes financiare nga ana e investitorit. Më lejoni të ju them këtu që Gjuriqi ka mundur të ketë ndikim dhe mund të ketë edhe në të ardhmën dhe këtë besoj që nuk mund ta ndalojmë, as unë edhe as ju dhe atëherë na tregoni se si mundemi pra ta ndalojmë, për shkak se ne nuk mundemi ta ndalojmë Gjuriqin për me dërgua letra të kushdo. Ne do të mundohemi që me punuar me investitorët të cilët e njohin sovranitetin e vendit tonë dhe unë këtë e kam thënë që nga dita e parë dhe nuk dua ta pranoj që Gjuriqi ka me pas ndikim por na nuk kemi me mundur ta ndalojmë në shkrime të letrave sepse ai mund ti shkruaj kujt të donë. Në anën tjetër për herë të parë nga institucionet e Republikës së Kosovës përkatësisht nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është ekzekutua një garancion bankar për mospërmbushje të kontratës dhe besoj që investitorët e kanë marrë shumë prej gjysmë milion euro sepse me zgjatjen e afatit prej gjashtë muajve ne kemi arritur ta rrisim qind për qind garancinë bankare dhe kjo është një sinjal. Këtu mund të thuhet se neve e kemi ruajtur

Brezovicën për shkak se ka mundur të nënshkruhet edhe kontrata edhe të mos bëhet projekti d.m.th për këtë unë kam kaq të themë.

Tash po filloj me komentet e kryetarit të Komisionit prof.Mustafa. Profesor ju e thatë që janë tre indikator që deputetëve ju intereson që është rritja ekonomike, eksporti, rritja e prodhimit vendor, përmirësimi i bilancit tregtar, punësimi edhe të tjera. Edhe unë po pajtohem plotësisht që këta janë ata indikator në anën tjetër më lejoni t'ju informoj që për përmirësimin e ambientit të biznesit në Kosovë nuk është përgjegjëse vetëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, unë jam përgjegjëse për të gjitha fushat për të cilat kam raport këtu unë atë strukturë të Ministrisë e kamë gjetur këtu unë nuk e kam ridizajnu Ministrinë, Ministria përbëhet prej tetë departamenteve dhe prej shtatë agjencioneve, neve e kemi infrastrukturën e cilësisë e cila është akreditimi, metrologjia, standardizimi, inspektorati, të gjitha këto janë në funksion të përmirësimit të produkteve vendore në mënyrë që ne të avancojmë sa i përket mardhënieve tregtare. Është fjala te ekzekutimi i kontratave është gjyqësori, Ministria e Drejtësisë kur është fjala tek hendeuku në mes të asaj forcës që prodhohet në universitete forcës së punës dhe asaj se çka kërkojnë ndërmarrjet është Ministria e Arsimit, kur është fjala tek politikat fiskale është Ministria e Financave, të energjia Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kështu që unë sot kam marrë komente dhe ju falënderoj shumë për komentet, por nuk jam këtu që të flas për shtat tetë Ministri të cilat kanë përgjegjësi në fusha të ndryshme ekonomike, në raportin e Bankës Botërore për të bërit biznes Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për dy indikator d.m.th për fillimin e biznesit edhe një është për nxjerrjen e Ligjit e Falimentimit për ekzekutimin e tij është Ministria e Drejtësisë, Gjykatat edhe Kontratat. Kështu që unë pres që në faktë ne të kemi ngritje pikërisht në indikatorë të cilët unë kam punuar.

Investimet e huaja direkte, u fol shumë se cilat janë shkaqet ne nuk i kemi shkaqet përpos të gjitha shkaqet të tjera të stabilitetit politik të institucioneve tona kanë ndikuar, unë mundem me e thënë tërë ditën por ka pasur investitor tek ne të cilët kemi qeë në negociata shumë të mira ku në aneksin e fundit në aneksin e shtatë e kemi numrin e kompanive të cilat KIESA-s i përcjell hap pas hapi deri në përfundimin e investimeve të tyre. Kemi diskutime shumë të singerta me investitorët ku destabilizimi i situatës politike ka ndikuar, ku më lejoni që të ju themë që në vitin e kaluar ku ne i kemi pasur 360 milion investime, ku Maqedonia i ka pasur vetëm 160 milion, dhe nëse i pyetni ata pse ata ju tregojnë që për shkak të stabilitetit politik, d.m.th këtu jemi përgjegjës të gjithë e jo vetëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Mirëpo, unë në fakt me iniciativën e komisionit funksional edhe me mbështetjen tonë financiare ndoshta edhe të donatorëve kisha propozuar që neve bashkërisht si iniciativë e përbashkët ta bëjmë një raport për të gjetur atë se çka ka ndikuar në rënien e investimeve të huaja edhe të shohim në mënyrë që të mos mbetet i njëanshëm.

Sa i përket udhëzimeve administrative për Ligjin për Investimet Strategjike, ne Kryetar i kemi dhënë vetës vetëm tre muaj që ti përpilojmë të gjitha udhëzimet administrative tash jemi duke punuar në argumentet për Gjykatën Kushtetuese me qenë se Ligji është atje dhe nuk kemi filluar ende.

Më lejoni që t'ju them që neve kemi një buxhet shumë të vogël kur folët për efektin e panairove ne i kemi 200 mijë euro për organizimin e konferencave dhe panairove. Një milion e cila është për subvencione ka shkuar vitin e kaluar po edhe këtë vit për Fondin e garanci kreditore. Unë vetëm në panairin e Parisit ku na i kemi dërguar shtat kompani, kur isha tash vendet e regjionit kishin investu dy milion, por edhe tre milion në shtandet e tyre, ne kemi dhënë komplet si ministri 10 mijë euro me ndihem e donatorve, edhe 32 mijë euro për të pasur mundësi me shkua dhe me qitë një stand atje, tani neve mund ti kemi referencat për vendet e tjera por po kan shtetet që 50 vitet apo 100 vite kan tradite, por po është shumë vështirë me u krahasua sado pak me to për shkak se nuk po kemi mundësi të krahasohemi me ta.

Buxheti në këtë vit kemi arritur që me negociim me Ministrinë e Financave ta rrisim në 7.2 milion, d.m.th që prej 5.4 milion kemi rritur në 7.2 milion për vitin 2017.

Sa i përket masave reciproke, ju e dini që unë jam për masa reciproke dhe kam qenë gjithmonë nuk është shumë për me marrë vendime për masa të reciprociteteve në momentin kur je nënshkrues i marrveshjes së CEFTA-s, në momentin kur ke nënshkruar marrveshjen e stabilizim asociimit etj. Fillimisht duhet me u argumentua tek ne prej ndërmarrjeve barrierat teknike dhe jo tarifore. Për momentin që asnjë barrierë nuk e kemi, nuk mundem unë të them me fjalë të ndëgjume iks kompanisë po i bëhet kjo edhe neve tash po e marrim vendimin, sepse në momentin që ndodh një gjë e tillë misionet diplomatike dhe ndërkomëtare thojnë se në çka jeni bazuar, duhet ti kemi argumentet që ajo kompanive të juaja po ju bëhet kjo e padrejtë. Ne jemi mundur që vazhdimisht me i informuar bizneset që në rastet kur kanë barrierë ata me raportua te ne, ne kemi edhe platformën online ku prej pikave kufitare mundemi me raportua, për momentin nuk kemi barrierë. Për reciprocitetin të gjitha këto vendime mundemi me i marrë për çka do kur të doni e nxjerrin një rekomandim apo një rezolutë dhe më bësoni se unë mezi s'pres për me implemetu.

Sa i përket cilësisë së karburanteve z.Qela, unë po ju tregoj kështu unë nuk mund të them që Ministria nuk ka bërë asgjë, dhe unë ju kam treguar që në momentin kur e kam marrë mandatin 45 % të pikave jo ato të Komunave, veriore dhe të veriut por 45% të pikave të karburanteve këtu që janë d.m.th kanë qenë të pa licencuara, verifikimi i të gjitha pikave janë bërë 380 e diçka kalibrime këtë vit. Na e kemi pru Ligjin, përgjegjës jemi bashkërisht për shkak se kam thënë që ka me i largua edhe trupat inspektues për shkak se kemi gjetë se ata nuk kanë bazë ligjore, udhëzimi administrative me të cilin ata janë autorizua është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për Konforomitet. Unë këtu e kam dokumentin, memorandum shpjegues që e kam dërgua tek Qeveria për bartjen e kompetencave në dogana edhe kjo shumë shpejtë do të ndodhë dhe neve i kemi dhënë kohë vetes dy muaj për me e bërë udhëzimin administrativ nga zyra ligjore e Kryeministrit e kanë kthyer dhe kanë thënë që kur ta bëni udhëzimin administrativ atëherë ejani dhe e kalojmë kompetencën. Pra kjo është çështje ditësh kur kometenca e trupave inspektuese kalon tek Doganat e Kosovës, ku ata e kanë edhe laboratorin. Kemi pasur probleme me furnizimin e laboratorit për shkak të komplikimeve në prokurorim që e dini që kemi sfida me të gjitha institucionet në momentin në momentin kur dojmë të bëjmë prokurime. Fillimisht njëra prej pajisjeve për me furnizua nuk i ka përmbush

kushtet teknike e kemi anuluar tenderin tash e kemi rishpall tenderin e kemi nënshkrua kontratën dhe jemi në furnizim e sipër. Ajo të cilën po dua ta them është që ju e thatë që duhet me e kontrollua qind për qind naftën, pikërisht këtu unë e kam propozua Ligjin e Naftës, kamë thënë që nafta prej pikës doganore me hy ne depo të naftës të gjithë importuesit e naftës duhet që ti obligojmë për me pas depo, për momentin janë 13 sish të cilët kanë depo, të tjerëve kemi pas dhënë afat edhe dy vite që ata me u pajisë me depo nëse duan me qenë importues, kështu që gjithsej i kemi 50 importues, ku 13 prej tyre kanë depo. Sepse në kohën e UNMIK-ut kështu ka qenë që nafta me hy prej kufirit me zbrit komplet ne depo. Ministria me mujt me kontrollua sasi shumë të mëdha edhe mandej mos me mujt me u penalizuar blerësit që e përmendet që shpesh herë penalizohet jo me fajin e tij. Për ndryshe nuk është e vërtetë që marrja e mostrave kushton më shtrenjët se analiza, marrja e mostrave kushton shumë lirë trupat inspektuese për momentin ngarkohen edhe për marrjen e mostrave edhe për analiza për ato i paguajnë vetë analizat dhe kjo çështje besoj se do të zgjidhet. Edhe tek kryeshefi, sekretari i përgjithshëm i jep d.m.th shpjegime.

Te deputeti Grainca, na kemi marrë masa kemi zhvillua me dhjetra takime, drejtorinë e përgjithshme për pranim të OBT kemi taku një numër të madh të vendeve anëtare, e kemi përgaditë edhe planin e veprimit edhe aplikacionin e kemi gati, neve në mënyrë shumë të sinqertë më ka thënë edhe drejtori gjeneral në pranim se edhe Kryeministri i juaj duhet ta merre mbështetjen nga Amerika, Evropa edhe në mënyrë specifike nga Gjermania për dhënien e aplikacionit d.m.th për aplikim. Ne kemi bërë, ryeministri është në diskutim me krerët kryesor të këtyre shteteve dhe shumë shpejtë kur vendosin, ne do e vendosim. Fondi për garanci kreditore është komplet funksional, janë 7.35 milion në fond janë nënshkrua marrëveshjet me shumicën e bankave komerciale. Bankat komerciale janë ato të cilat kreditë e caktuara vendosin nën ombrellën e fondit.

Tek Ministria e Punëve të Jashtme ajo e cila është rekomandua prej disa deputetëve, beso që unë vetëm e ka përfunduar këtë punë këtë bisedë kam diskutuar me Ministrin Hoxhaj që të paktën zavendësimi i stafit me qenë që ka kosto buxhetore, dhe nuk mund të rritim numrin e stafit të paktën zëvendësimi i stafit të bëhet me ekspert ekonomik në mënyrë që ne në secilën ambasada ta kemi një atashe ekonomik.

Te parku i Drenasit është e vërtetë që ka filluar shumë herët ka kushtuar shumë, mirëpo në mandatin tonë ajo çka ka ndodh në atë park është që është popullu komplet parku, janë 38 biznese edhe dy hapësira tash e kemi, tash që jemi edhe në proces të marrjes nga ana e investitorëve që ja u kemi ndarë por nuk e kanë kryer investimin. Ajo që ka ndodh në vitin e kaluar është që kemi investua ne ngritjen e kapacitetit të energjisë elektrike sepse ka qenë kërkesë e bizneseve në park edhe tjetra e cila po ndodh në këtë vit është d.m.th ndërtimi i dy stacioneve të autobusëve për të gjithë punëtorët e parkut dhe është ndërtimi i një mbikalimi përndryshe neve nuk kemi mbaru asnjë investim. Ajo çka po punojmë është për zgjerimin e parkut ku ideja ka lind në vitin e kaluar ku prej neve nuk është fol më herët janë 75 hektar që duhet për me shkua në procedura të shpronësimit. Në buxhetin që Ministria e ka nuk mund për me përfundua këtë park edhe pesëdhjetë vite. Ne jemi duke negociua edhe me bankën evropiane

për rindërtim dhe zhvillim që të marrim një kredi dhe që të investojmë, jo vetëm në këtë park por të investojmë edhe në parqe të tjera industriale, tani ende nuk janë zona të lira ekonomike sepse koncept i Qeverisë është se Kosova është territor i vogël dhe nuk e kemi komoditetin për me krijuar hapësira brenda të territorit tonë ku bizneset mundën me operuar pa taksa, konsiderojmë se në fiskal jemi në rregull.

Tek deputeti Konjufca, besoj që për Brezovicen veç fola, tek mbledhja e të hyrave në doganë është përgjegjëse Ministria e Financave, por nuk është e vërtetë se nuk e kemi bërë shumë, kemi bërë shumë hapa për shkak se ju e dini që kemi ndërmarrë reformën fiskale e cila për herë të parë ka barazuar pozitën e tregtarit me atë të prodhuesit duke e liruar nga taksat doganore dhe TVSH, të gjitha inputet makinerinë lëndën e parë e të tjera. Në anën tjetër ju e dini se po punohet me shumë intensitet në projektin e bashkimit të doganës dhe ATK me një agjenci të hyrave dhe gradualisht kalohet nën mbledhjen e TVSH brenda vendit dhe jo në kufi këto janë politika që nuk mund të bëhen me një vendim, mirëpo gradualisht.

Tek marrëdhëniet tregtarë me Serbinë si partner kryesor ne po bëjmë përpjekje që të ketë trajtim fer të kompanive tona nga ana e tyre përndryshe e dijme që edhe ne është pak problematike ne kemi menduar se me nënshkrimin e marrëveshjeve me stabilizim asocimi edhe kompanitë do të kthehen nga tregu evropian. Unë personalisht kam menduar se do të sjellin produkte më kualitative, ju e dini se ne kemi ekonomi të treg të lirë, nuk mund të mësojmë kompanitë tregtare se prej ku të furnizohen ajo që ndoshta mund të bëjmë në marrjen e masave reciproke dhe besoni se kjo duhet të bëhet sa herë që ka nevojë, tradicionalisht kompanitë kanë punuar dhe nuk i kanë shkëput këto marrëdhënie tregtare.

Ju i përmendet e gjeturat e auditorit, unë në mbledhjen e parë në komision që ë kam mbajtur si ministre kamë treguar se e kam gjetur në gjendje komplet të qorganizuar në emër të një riorganizimi dhe këtë e kam ngritur, kam shkuar në zyrën e kryeministrit në mbledhjen e sekretareve e tjera por e kam parë që një riorganizim i tillë ka ndodh dhe besoni që nga problemet e shumta në sferat e tjera besoni se nuk kam pasur kohë ti hyjë një riorganizimi tjetër. Ajo çfarë ka ndodhë është se njerëzve në emër të këtij riorganizimi ju kanë ndërruar pozitën d.m.th. është problem i trashëguar i kemi diku rreth 40 veta që në atë kohë është ngritur koeficientin por asnjëherë ministria e administratës para mandatit tim nuk i ka aprovuar këta koeficienta, këta persona vazhdojnë të bëjnë ankesa qoftë të komisionet disiplinore qoftë të këshilli mbikëqyrës i pavarur për shkak se ata kanë vendime për rritje të koeficienteve në mënyre joligjore. Unë asnjëherë nuk mund ti aprovoj se nuk e kam vendimin e ministrisë administratës publike dhe ministrisë së financave sa herë kemi ngritur këto çështje janë thënë se po punohet për ligjin për paga, po punohet në katalogun për vendet e punës dhe këtë nuk mund ta zgjidhim. Ne edhe zyrës të auditorit i kemi bërë të qartë këto i kemi dërguar letra se ministrin e financave, në ministrinë e administratës publike që nuk janë gjëra që ne i zgjedhim. Tani kemi filluar me procesin e përshkrimit të saktë të vendeve të punës dhe procesin e riorganizimit në mënyre që të kemi një përputhje në mes të ligjeve për secilin agjenci dhe departament dhe rregulloresve d.m.th. kemi filluar me grupet punuese për ndryshim rregullimin e rregullores 27/2012. Sa i përket fondit të kuadrove në raportin e auditorit unë personalisht që kamë lexuar

unë nuk kam parë sa u përket fondeve të kudrave besoni se me insistimin tim është larguar fondi i kuadrove, pasi që ka qenë fondi që është keqpërdorur më së shumti në ministrin e tregtisë dhe industrisë. Është fatkeqesi, shumë persona kompetent që kanë punuar po na ikin se nuk po mund ti mbajmë brenda në anën tjetër kanë pasur keqpërdorime të hatashme njerëz të cilët kanë marr bursa dhe kanë nënshkruar kontrata me Qeverinë e Kosovës për tu punësuar për të studiuar jashtë vendit edhe për tu kthyer për të kontribuar në institucione 3 vite. Ata kanë qenë përfitues në fakt ata jashtëligjshëm kanë qenë përfitues. Unë kam gjetë në ministrin e tregtisë dhe industrisë kryeshefat e agjensioneve kanë qenë përfitues të fontir kuadrove, a kryeshefat e kanë koeficientin sa të ministrit, njëjtë kanë ndodhur edhe në ministrit të tjera. Kemi qenë më transparentet në këtë proces. Normalisht edhe të gjithë personat që janë hapur hetime ne i kemi larguar ose suspenduar.

Tek letra jo nuk i kemi dërguar letër Gjuriqit, kompanive ju kemi dërguar letra i kemi edhe në fakte jo vetëm që ju kemi dërguar letra por ju kemi rikujtuar tema e referencave të kontratave kur qeveria merr përsipër e plotë e pronësinë e aseteve e cila ajo jep në shfrytëzim.

Deputeti Berisha i cili foli për naftën, është e vërtetë se asnjëherë nuk është bërë kalibrimi, unë kur kam shkuar në ministri 4 vite më herët, asnjëherë nuk është bërë më herët nuk ka ndodhur kalibrimi i pika në vende është e vërtetë që nuk kemi arritur të bëjmë kalibrimi me gaz pasi që kemi pasur pajisjen në defekt e kemi blerë pajisje e kemi nënshkruar kontratën besoj se herën tjetër në raport do të kemë edhe këtë ndodhur kalibrimi i pikave.

Tek prodhimet vendore ne nuk kemi buxhet për ndonjë formë të stimulimit apo dhënje të subvencioneve unë vet e kam ngritur edhe në qeveri ne e kemi mbështet që një kohë ministrinë e bujqësisë me subvencione dhe grande në mënyrë që të rritim kapacitetet përpunuese. Për momentin kemi këtë buxhet që kemi kemi kërkuar nga fondet e IPA-s që të kemi mundësi me ato mundësi që kemi po mundohemi që ti promovojmë tek politikat industriale ne i kemi 8 studime të profileve të ndryshme sektoriale që tregojnë ku dhe sa janë potenciale për zhvillimin e këtij e thashë edhe më herët në bashkëpunim me USAID.

Tek licencae veriut tregova se nuk janë të licencuara janë 25 veta të strukturave paralele që janë shkri në institucioneve në ministrinë e të tregtisë dhe industrisë këta janë trajnuar po punojnë për inspekteriotin e tregut dhe punës dhe tregut unë ju kam bërë me dije se ata nuk janë në listë të pagave nëse refuzojnë të kryejnë obligimet sipas detyrës, tani ata ende nuk kanë zyre dhe vetura, Ministra e Administratës Publike, obligohet që më pajisë në momentin pajisjes obligohen më fillu me licencimin.

Tek deputeti Rexhepi, për efektet e parkut të biznesit të zonave ekonomike, kur flasim së sa është investua atëherë lenë për të dëshirë për efektet e tyre, mirëpo, në parkun e Drenasit janë 38 biznes duke vepruar ne kemi edhe parkun e biznesit teknologjik të Shtimes, vetë komunat kanë bërë kërkesa ne MTI-i që të licencohen hapësira për parqe industriale, kjo është një mundësi e mirë sepse MTI-ja ju ofron komplet infrastrukturën fizik të shërbimeve, për zgjerim të kapaciteteve ekzistues ose të bizneseve të reja, ashtu një ofertë e mirë para investitorëve, kur

ju tregon se ke 5-6 zona industriale në Kosovë dhe ata mund të vendosën pa asnjë problem në këto zona. Sot siç e dini kostoja e konjektivit në energji elektrike është shumë e shtrenjët sidomos pas privatizimit të rrjetit për distribucionet, në këto zona ofrojmë kapacitete ku investon Qeveria dhe nuk kanë nevojë bizneset edhe lehtësohet, mandej tretmanët e ujërave të zeza, furnizim me ujë, siguri etj. Për ambientin e biznesit jemi përgjegjës të gjithë.

Tek raporti të deputeti Beqaj, po e perseris prap se struktura e Misintrisë së Tregtisë dhe Industrisë është kjo, nëse jeni të interesuar të shihni raporte të detajuara tregtare në ju sjellim, sa i përket politikave industriale në i kemi 8 profile për industri të ndryshme dhe potencialin që duhet ta zhvillojmë, ju thash jemi në zhvillim e sipër të “klastereve” kemi formuar 4 “nukleuseve” jemi në zhvillim e sipër edhe të dy “nukleuseve” të tjera të cilat priten që të zhvillohen në “klastër” dhe bëjnë kryesisht dmtë hartimin e politikave industriale. Për të mbështetur industri të ndryshme nuk kemi buxhet, andaj, edhe nuk mund të raportojmë më shumë. Raportet për shkëmbime tregtare i prodhon zyra statistikore në as nuk i kemi në mandat sipas rregullores për fushat dhe përgjegjësitë e ministrive, këtë strukturë të ministrisë me 7 agjensione dhe 8 departamente unë e kam gjetur aty dhe sipas rregullores së Qeverisë për fushat dhe përgjegjësitë e ministrive është ky përshkrim i punëve, andaj, unë nuk mund të dal jashtë kësaj rregullore dmtë për dy mandate dhe ju e keni pasur pikërisht këtë. Faleminderit.

BESIM BEQAJ: Unë besoj që duhet të kuptohemi drejtë lidhur me politikën e tregtisë sigurisht që unë pash në politikën tregtare në aneksin 2, ju i jeni referuar disa studimeve, për neve është me rëndësi me ditë në bazë studimeve të cilat i keni bërë cilat janë 5 industritë me të rëndësishme të Kosovës, të cilat kanë më prioritet, ndërsa mbi bazën e asaj që a keni kompetencë me hartu raporte periodike për tregtinë e jashtme.

Ju në raportin tuaj për politikën tregtare thonë kemi përgaditur raportet periodike për tregtinë e jashtme, janë përgadit të dhëna statistikore dhe analizat për marrjen e tyre në njësitë eksportuese, janë përgatit raporte për ndikimin në marrëveshjet tregtare pra vetë fjala e Misintrisë së tregtisë, janë obligime në kompetencën tuaj që duhet të bëni. Prandaj mbi këtë bazë është mirë që kur ti bëni raportet, unë spo them që nuk e dini por po them që kur ti bëni raportet 5 industritë me të rëndësishme të Kosovës janë këto, sipas analizave të bëra. Vetëm po ju pyes a i keni 5 industritë me të rëndësishme të Kosovës në këtë raport.

KRYETARI: Lirisht mund të ju them se statistika e jonë nuk na tregon se cilat industri, pak duhet të kqyrni, edhe ju keni qënë shumë gjatë në Qeveri, edhe është dashtë me i aftësu atë statistikë që me na i dhënë këto. Prandaj ju smund ti ikni asaj që nuk keni, jeni të obliguar ta dini, unë e kam shtruar disa herë në diskutim edhe këtu dhe ju lutem agjensioni i statistikave është brenda Qeverisë, andaj kërkoni nga ata me ju dhënë statistikat e prodhimit të industrisë sepse pa i pasur ato nuk mund t’i përgjigjeni në pyetjen e shtruar nga z.Beqaj, por në e kemi toleruar këtë agjension të statistikave me dekada për mos me i dhënë këto. Unë i kam shtruar këto pyetje disa herë dhe Kuvendi ka vendosë duheni me zbatu ato se agjensioni i statistikave duhet me dhënë strukturën e prodhimit të Kosovës, duhet me dhënë shumë ma mirë tregtinë e jashtme se ministrja tha në nuk i mbajmë statistikat, ju nuk i mbani statistikat por duhet me

analizu statistikat mi marr prej agjensise se statistikave me krijuar raport, unë mundohem çdo muaj me pas, por ajo jep muaj për muaj dhe nuk kupton kurgjo sepse një muaj mundet me dhënë eksportin tjetrin muaj mundet me u rrit kjo është absurditet, edhe ju kam thënë disa here ju duheni me ndryshu atje ajo duhet me na i dhënë për 6 muaj, ju kam thënë edhe atyre sdi ku e kanë marrë atë formularë, 3- 4 gjera ajo nuk është duke na i dhënë.

Nen 1... qe folëm sot, nën 2 nuk e dijmë sa njerëz hyjnë ne punë në Kosovë, a e kemi prioritet punësimin dhe shumë gjera të tjera, por unë pajtohem me z. Beqaj, me atë se sa kemi rritje ekonomike, si shkuan investimet, si shkoj eksporti këto 3 gjera plotësisht është me vend qe ju keni marr një aktivitet shumë te gjerë dhe po shihet qe keni punuar shumë dhe për këtë ju përgëzojmë por ne dëshirojmë të shohim rezultate ne këto tria, një vit mund te shkoni me keq por ne vitin tjetër përmirësoheni, je keni bërë kthesa te rëndësishme dhe për këtë ju përgëzojmë. Dhe tjetra për këtë tregtinë e naftës, për cilësinë e naftës u diskutu shumë gjatë kisha dasht që në mbledhjen tjetër pasi ju keni filluar aktivitete me u përfundu punët qe i keni marrur mos mu diskutu më të njëjtat gjana i kemi diskutu edhe herën e kaluar dhe sigurisht qe janë probleme dhe ministria ka telashe me akte te caktuara qe jane kriju por ato duhet qe më me guxim të hiqën dhe vitin e ardhshëm ta dijmë që cilësia po kontrollohet.

Tjetër ajo qe neve na intereson dhe qe është në funksion të rritjes ekonomike dhe në funksion të zbutjes se bilancit të pagesave çoftë me zëvendësim te importit, çoftë me rritje te eksportit, ne do te shohim se si do t'i mbrojmë, nëse nuk do të mund ti mbrojmë në mënyre të lehtë duhet t'i mbrojmë në mënyre indirekte apo direkte sepse industria emergjentë e Kosovës për me u bërë konkurrencte i duhen edhe 20 vite, edhe 20 vite Kosova nuk mundet me duruar këtë deficit dhe këtë nivel të punësimit.

Prandaj, këto probleme nuk lidhen vetëm me Ministrin tuaj, por edhe me ministri të tjera, mirëpo, ju duheni me i marr me i realizuar, mr i problematizu se çka ju duhen, e me ardh ne Komision ne ju japim ndihme. Çka ju takon në Qeveri sigurisht që edhe atje do të merrni ndihmën, unë me kënaqësi konstatoj se ju keni punuar shumë punë, janë bërë shumë punë por ka edhe shumë sfida, këtu po e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës. Përgjigjuni me shkrim për të tjerat sepse nuk kemi kohë.

Përqaditi:

Njësia mbështetëse e Komisionit